



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

UDHËZUES PËR ZHVILLIMIN E LËNDËS SË GJUHËS SË HUAJ NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË

Material në ndihmë të mësuesit

2023

Koordinoi hartimin e udhëzuesit

Ludmilla Stefani, ASCAP

Koordinoi redaktimin shkencor

Dr. Gerti Janaqi

Dr. Dorina Rapti

Koordinoi redaktimi letrar

Miranda Kurti

Koordinoi faqosjen

Eriksen Mersinllari

Prodhim i ASCAP, 2023

www.ascap.edu.al

Copyright ©, ASCAP

TABELA E PËRMBAJTJES

I. QËLLIMI I UDHËZUESIT TË LËNDËS “GJUHË E HUAJ”	5
1.1 Qëllimi i udhëzuesit	5
1.2 Përdoruesit e udhëzuesit.....	5
1.3 Struktura e udhëzuesit	5
II. RËNDËSIA E LËNDËS “GJUHË E HUAJ”	6
2.1 Qëllimi i mësimdhënies dhe të nxënit në lëndën “Gjuhë e huaj”	7
2.2 Risitë e lëndës së “Gjuhës së huaj”.....	7
2.3 Shtrirja e lëndës “Gjuhë e huaj”	9
III. ZHVILLIMI I KOMPETENCAVE KYÇ NËPËRMJET KOMPETENCAVE TË LËNDËS “GJUHË E HUAJ”.	11
IV. INTEGRIMI NDËRLËNDOR	15
V. TEMAT NDËRKURRIKULARE	20
VI. METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIE – NXËNIES NË GJUHËN E HUAJ	22
VII. PLANIFIKIMI I LËNDËS DHE MODELE TË PLANIFIKIMIT LËNDOR.....	39
7.1 Llojet e planifikimeve	39
7.2 Planifikimi vjetor i lëndës	40
7.3 Planifikimi sipas periudhave	43
7.4 Planifikimi ditor	47
VIII. VLERËSIMI I NXËNËSVE NË LËNDËN E GJUHËS SË HUAJ	62
8.1 Vlerësimi i vazhduar (për të nxënë).....	62
8.2 Vlerësimi i të nxënit (testi përmbljedhës)	63
8.3 Vlerësimi me projekt kurrikular.....	64

8.4 Vlerësimi i nxënësve me nevoja të veçanta	80
IX. KRITERET DHE REFLEKTIMI PËR DETYRAT E NDRYSHME NË LËNDËN E GJUHËS SË HUAJ	80
9.1 Kriteret për kryerjen e detyrave	80
9.2 Reflektimi ose komenti i mësuesit (Giving feedback)	81
9.3 Shembuj për kriteret e vlerësimit të detyrave.....	81
X. TESTET E ARRITJEVE	85
10.1 Parimet e hartimit të testeve nga mësuesi	86
10.2 Hartimi i testit	87
10.3 Llojet e pyetjeve që hartohen në teste	88
10.4 Modele testesh.....	104
XI. NIVELET E ARRITJEVE.....	117
XII. NDRYSHIME POZITIVE QË SJELL VLERËSIMI BAZUAR NË KOMPETENCA	121
XIII. BIBLIOGRAFIA	123

I. QËLLIMI I UDHËZUESIT TË LËNDËS “GJUHË E HUAJ”

1.1 Qëllimi i udhëzuesit

Udhëzuesi kurrikular për lëndën “Gjuhë e huaj” synon të ndihmojë mësuesit e “Gjuhës së huaj” të arsimit të mesëm të lartë (AML) në punën e tyre të përditshme për zbatimin e programeve mësimore të bazuar në kurrikulën me kompetenca, si edhe drejtuesit dhe specialistët e arsimit për monitorimin e kësaj kurrikule.

Udhëzuesi është hartuar për të mbështetur mësuesit e “Gjuhës së huaj” të planifikojnë mësimet krijuese, kuptimplote dhe argëtuese për nxënësit duke përzgjedhur veprimtari dhe strategji të përshtatshme, të cilat do të ndihmojnë nxënësin në procesin e marrjes së njohurive. Fokusi i është dhënë mësimdhënies dhe veprimtarive me në qendër nxënësin, pasi nxënësit mësojnë më mirë kur janë pjesë e këtij procesi. Nxënësit mësojnë nëpërmjet situatave të të nxënit ku tekstet e leximit trajtojnë tema të interesit të tyre, të cilat përshtaten me zhvillimin moshor dhe nivelin gjuhësor. Ata, gjithashtu, realizojnë detyra dhe projekte që shkojnë përtej klasës dhe shkollës duke zbuluar në këtë mënyrë se si funksionojnë gjërat në shoqëri dhe në komunitet, pjesë e të cilit janë edhe ata.

1.2 Përdoruesit e udhëzuesit

Udhëzuesi u vjen në ndihmë punonjësve arsimorë në sistemin e arsimit parauniversitar dhe si i tillë përdoret nga:

- mësuesit, drejtuesit e shkollave, nxënësit, prindërit të cilët punojnë së bashku për të përmirësuar cilësinë e të nxënit dhe rezultateve të nxënësve në lëndën e “Gjuhës së huaj”;
- të gjitha institucionet arsimore në varësi të MAS, njësitë arsimore vendore për zhvillimin profesional, këshillimin, vëzhgimin, monitorimin, kualifikimin e punonjësve arsimorë;
- institucionet e arsimit të lartë që përgatisin mësues në lëndën e “Gjuhës së huaj”, të cilët mund t’i referohen për formimin fillestar të mësuesve të rinj.

1.3 Struktura e udhëzuesit

Udhëzuesi mundohet të japë përgjigje për një sërë pyetjesh dhe çështjesh të ngritura nga drejtuesit e shkollës, mësuesit, nxënësit, prindërit të cilët herë pas here kanë dilemat e tyre në lidhje me zbatimin e kurrikulës me kompetenca në lëndën e “Gjuhës së huaj”.

Udhëzuesi përfshin

1. Modele të zhvillimit të kompetencave kyç nëpërmjet lëndës së “Gjuhës së huaj”.
2. Modele të integritit ndërlëndor brenda dhe jashtë fushës së të nxënit.

3. Metodologji për zhvillimin e lëndës së “Gjuhës së huaj”.
4. Modele të planifikimit kurrikular të lëndës “Gjuhë e huaj”:
 - (a) modele të planifikimit vjetor;
 - (b) modele të planifikimit të periudhës;
 - (c) modele të planifikimit ditor;
 - (d) model planifikimi të projektit në lëndën “Gjuhë e huaj”;
 - (e) modele të punës me PEGJ (Portofoli Evropian i Gjuhëve).
5. Vlerësimi i nxënësve:
 - a. modele të vlerësimit të vazhduar;
 - b. modele të vlerësimit të projektit.
6. Teste të arritjes:
 - a. parimet e hartimit të testeve;
 - b. lojet e pyetjeve që hartohen në teste;
 - c. model testi për një periudhë.

Për trajtimin e këtyre çështjeve në këtë udhëzues operohet në dy drejtime:

së pari, duke dhënë shembuj konkretë dhe modele për çështje të tilla si planifikimi i mësimdhënies, vlerësimit, punës me PEGJ, apo forma dhe metoda pune për realizimin me sukses të orës mësimore;

së dyti, duke dhënë sugjerime për një mësimdhënie më cilësore duke pasur si kriter zbatimin e programit mësimor të lëndës “Gjuhë e huaj”.

II. RËNDËSIA E LËNDËS “GJUHË E HUAJ”

Lënda “Gjuhë e huaj” (anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht etj) ndihmon nxënësin të zhvillojë kompetencën kyç të komunikimit dhe të shprehurit si edhe synon zhvillimin gjuhësor dhe letrar, i cili është boshti themelor për rritjen intelektuale, sociale, kulturore dhe emocionale të nxënësit duke pasur për mision aftësimin dhe orientimin e nxënësit për të vepruar në situata të ndryshme komunikimi në gjuhë të huaj. Lënda “Gjuhë e huaj” edukon nxënësin me të kuptuarin, pranimin, vlerësimin dhe respektimin e kulturave dhe mënyrave të jetesës së popujve të tjerë, duke e bërë atë të pavarur dhe të aftë të përballojë të nxënit gjatë gjithë jetës. Nxënësi, gjithashtu, mëson dhe bindet se gjuha e huaj, si një subjekt njohurish, aftësish, kulturash dhe vlerash, kërkon kohë dhe praktika të shumëllojshme komunikimi për t’u përvetësuar.

Për më tepër, në kontekstin e sotëm social dhe politik, ku lidhjet globale janë gjithnjë dhe më të qëndrueshme, si dhe kur Shqipëria aspirojnë të integrohet në Bashkimin Evropian, prirja kryesore është krijimi i një mjedisi shumë gjuhësor e shumë kulturor, në të cilin mësimi i gjuhës së huaj kontribuon si në shkëmbimet kulturore midis vendit tonë dhe vendeve të ndryshme, ashtu edhe për të udhëtuar botën, qoftë për shkollim apo për kënaqësi.

2.1 Qëllimi i mësimdhënies dhe të nxëniet në lëndën “Gjuhë e huaj”

Qëllimet e lëndës “Gjuhë e huaj” në arsimin e mesëm të lartë janë që nxënësi:

- të ndërgjegjësohet për aspektet kulturore të gjuhës së huaj që po mëson, të reflektojë mbi ndryshimet mes praktikave kulturore të vendit ku flitet ajo gjuhë dhe gjuhës dhe kulturës amtare si edhe të këto tradita, kultura dhe vlera;
- të zhvillojë më tej kompetencën e të folurit dhe të komunikuarit duke përdorur njohuritë dhe aftësitë gjuhësore në situata praktike të jetës së përditshme, për të hulumtuar dhe dhënë përgjigje e argumente për çështje të interesit të tij;
- të forcojë ndërveprimin në situata nga jeta e përditshme dhe jashtë shkollore lidhur me tematikën e trajtuar në situatat mësimore dhe të shkëmbejë informacione të detajuara mbi tema që paraqesin interes për të;
- të konsolidojë bashkëveprimin ndërmjet punës në grup dhe punës së pavarur individuale dhe të thellojë njohuritë gjuhësore, perceptuese dhe shprehëse;
- të zhvillojë rrjedhshmërinë në gjuhën e huaj përmes praktikës së vazhdueshme të përshtatshme për moshën, interesat dhe nivelin e tij gjuhësor;
- ta përdorë gjuhën e huaj që po mëson për të zgjeruar njohuritë edhe në lëndët e tjera.

2.2 Risitë e lëndës së “Gjuhës së huaj”

Trajtimi i lëndës së “Gjuhës së huaj” nëpërmjet kompetencave është risia kryesore e programeve lëndore të “Gjuhës së huaj”. Me kurrikulën e re, gjuha e huaj është strukturuar me tri kompetenca, të cilat janë përshtatur nga Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencave për Gjuhët dhe shpjegohen në tabelën e mëposhtme:

KOMPETENCAT E LËNDËS		REZULTATET E TË NXËNIT (NIVELI B2)
1. GJUHËSORE	a. Fjalori	Nxënësi zotëron fjalor të pasur për tema

<i>Kompetenca gjuhësore ka të bëjë përvetësimin e rregullave gramatikore, semantike, fonetike, ortografike si dhe pasurimin e fjalorit.</i>		të përgjithshme dhe ato që lidhen me fushën e tij të interesit. Nxënësi përdor formulime të ndryshme fjalish për të shmangur përsëritjet, por akoma mund të vihen re momente hezitimi. Saktësia gjuhësore është në përgjithësi e lartë megjithëse mund të shfaqen momente konfuzioni pa ndikuar në komunikim.
	b. Saktësia gramatikore	Nxënësi tregon shkallë të lartë kontrolli gramatikor duke mos bërë gabime të cilat mund të çojnë në keqkuptime.
	c. Fonetika	Nxënësi ka fituar shqiptim dhe intonacion të qartë dhe të natyrshëm.
	d. Ortografia	Nxënësi shkruan në mënyrë inteligjente tekste të gjata dhe të qarta duke zbatuar strukturën standarde të organizimit të paragrafëve dhe të gjithë tekstit. Drejtshkrimi dhe pikëzimi janë të saktë, por mund të ketë shenja të influencës së gjuhës amtare.
2. SOCIO-GJUHËSORE <i>Kompetenca socio-gjuhësore ka të bëjë me dimensionin shoqëror të gjuhës dhe i referohet të mësuarit të akteve të ndryshme të ligjërimit dhe komunikimit në kontekste të ndryshme shoqërore, të cilat kanë të bëjnë me statusin shoqëror, gjininë, moshën e nxënësit, si dhe me faktorë të tjerë që influencojnë në stilin dhe regjistrat e gjuhës.</i>	a. Aktet e ligjërimit dhe komunikimit	Nxënësi me pak përpjekje merr pjesë dhe vazhdon një diskutim në grup edhe kur flitet shpejt dhe me shprehje idiomatike. Nxënësi gjithashtu diskuton me një folës vendas të asaj gjuhe duke mos shkaktuar keqkuptime dhe duke u shprehur në mënyrë të përshtatshme dhe pa gabime në formulimin e ideve.
3. PRAGMATIKE <i>Kompetenca pragmatike ka të</i>	a. Fleksibiliteti	Nxënësi përshtatet kur në diskutim ndryshohet tema dhe stili duke përshtatur

<i>bëjë me njohjen e rregullave dhe parimeve sipas të cilave mesazhi komunikues organizohet dhe strukturohet (zhvillimi i temës, lidhja logjike e ideve, koherenca e mendimeve) dhe realizimin e funksioneve komunikuese (kërkimi i informacionit, dhënia e këshillës, kërkimi për ndihmë, rënia dakord, përshëndetjet etj.).</i>		formulimet sipas rastit.
	b. Pjesëmarrja në bashkëbisedim	Nxënësi ndërhyr në mënyrë të përshtatshme në diskutime. Nxënësi fillon, vazhdon dhe përmbyll diskutimin në mënyrë efektive duke e marrë radhën aty kur duhet dhe në mënyrë të përshtatshme.
	c. Zhvillimi i temës	Nxënësi tregon ose përshkruan në mënyrë të qartë duke zgjeruar dhe mbështetur pikat kryesore me shpjegime dhe shembuj të detajuar.
	d. Koherenca	Nxënësi përdor mjete të kufizuara lidhëse për të realizuar të folur të qartë dhe koherente.

Dy faktorë cilësorë, të cilët përcaktojnë suksesin e nxënësit në realizimin e funksioneve komunikuese janë:

- a. Rrjedhshmëria b. Saktësia e të shprehurit

Duke u bazuar tek kompetencat kyç dhe ato të komunikimit gjuhësor, nxënësi përdor aftësi dhe strategji të përshtatshme për përmbushjen e detyrave në veprimtaritë gjuhësore (me shkrim dhe me gojë): **marrja e informacionit** (të lexuarit, të dëgjuarit), **ndërveprimi** (të folurit ndërveprues, të shkruarit ndërveprues), **produkti** (produkti i të folurit, produkti i të shkruarit) dhe **ndërmjetësimi** (përmbledhja, interpretimi, perifrazimi, përkthimi etj.). Kryerja e vazhdueshme e veprimtarive gjuhësore bën që nxënësi të forcojë aftësitë dhe shkathtësitë e **të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit.**

2.3 Shtrirja e lëndës “Gjuhë e huaj”

Lënda “Gjuhë e huaj” është planifikuar në kurrikulën bërthamë si një lëndë me rëndësi për formimin e nxënësit duke filluar që nga arsimi fillor dhe përbëhet nga gjuha e huaj e parë dhe gjuha e huaj e dytë.

Gjuha e huaj e parë (gjuha angleze) fillon në shkallën e parë (klasa I) dhe mësohet deri në shkallën e gjashtë (klasa XII).

Gjuha e huaj e dytë fillon të mësohet në shkallën e tretë (klasa VI) dhe vazhdon deri në shkallën e gjashtë (klasa XII).

Klasa	X	XI	XII	Niveli i synuar
Gjuha e huaj e parë	3	3	3	B2
Gjuha e huaj e dytë	2	2	2	A2+

Duke ju referuar *Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët* dhe programeve të lëndës “Gjuhë e huaj” në AML, nxënësi synon të arrijë deri në fund të klasës së 12-të nivelin B2 për gjuhën e huaj të parë dhe A2+ për gjuhën e huaj të dytë.

Më poshtë jepet përshkrimi i nivelit A2 dhe B2 sipas shkallës globale të Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët.

Shkalla Globale A 2	Nxënësi: - mund të kuptojë fjali dhe shprehje të përditshme që lidhen me fusha të nevojës më të domosdoshme si p.sh: informacion bazë rreth tij dhe familjes, në dyqan, gjeografia e vendit, puna/ët që bën; - mund të komunikojë për detyra të thjeshta dhe rutinë që kërkojnë shkëmbim informacioni të drejtpërdrejtë për çështje të njohura dhe të përditshme; - mund të përshkruajë me terma të thjeshta aspekte të formimit të tij/saj, mjedisit rrethues dhe çështje të fushave me interes/nejvojë të drejtpërdrejtë.
----------------------------	--

**Shënim: Niveli A2+ është më i lartë se A2, gjithsesi ato kanë të njëjtat tipare kryesore duke shtuar përshkrues të cilët fokusohen në sasinë e shkëmbimit të informacionit duke përcaktuar si karakteristikë të këtij niveli pjesëmarrjen më aktive të nxënësit në diskutime dhe bashkëbisedime duke u ndihmuar nga bashkëfolësi ose mësuesi.*

Shkalla Globale B2	Nxënësi: - mund të kuptojë idetë kryesore të një teksti kompleks mbi çështje konkrete dhe abstrakte duke përfshirë diskutime teknike në fushën e tij të specializimit; - mund të bashkëveprojë rrjedhshëm dhe spontanisht duke e bërë komunikimin me folës vendas të mundshëm pa vështirësi për secilën palë; - mund të prodhojë një tekst të qartë, të detajuar rreth një sërë temash dhe shpjegojë pikëpamjet e tij për një çështje të ditës, duke dhënë avantazhe dhe disavantazhe për opsione të ndryshme.
---------------------------	---

**Shënim: Nxënësi në nivelin B2 konsiderohet si përdorues i pavarur i gjuhës. Dy tiparet kryesore të këtij niveli janë (a) nxënësi diskuton natyrshëm, rrjedhshëm dhe në mënyrë efektive pa ndihmën e shokëve ose të mësuesit, (b) nxënësi është në gjendje të korrigjojë gabimet e veta dhe të monitorojë të folurën e tij.*

Këto përshkrime detajohen më tej në Portofolin Evropian të Gjuhëve (PEGJ) dhe përdoren nga mësuesi si bazë për të përcaktuar nivelin e arritjeve të nxënësit për çdo klasë.

III. ZHVILLIMI I KOMPETENCAVE KYÇ NËPËRMJET KOMPETENCAVE TË LËNDËS “GJUHË E HUAJ”.

Lënda “Gjuhë e huaj” krijon hapësirë për nxënësin të zhvillojë jo vetëm kompetencat gjuhësore, por edhe ato kyç për dy arsye kryesore:


a. Të nxënit është i orientuar drejt përdorimit të gjuhës në jetën e përditshme

Përqasja e adoptuar nga Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencave për Gjuhët (KPER) në të mësuarin e gjuhëve të huaja është e orientuar drejt të vepruarit ku nxënësi konsiderohet si “aktor shoqëror” d.m.th., anëtar i shoqërisë, që ka detyra për të përmbushur (të cilat nuk janë vetëm gjuhësore) në rrethana dhe në një mjedis të caktuar dhe brenda një fushe të caktuar veprimi. Komunikimi realizohet nëpërmjet veprimtarive gjuhësore, të cilat janë pjesë e një konteksti më të gjerë shoqëror që u jep atyre kuptim të plotë. Përqasja vepruese merr gjithashtu parasysh burimet njohëse, emocionale, të vullnetshme si edhe tërësinë e aftësive, që zotëron dhe vë në jetë çdo individ si një aktor shoqëror.

Në bazë të kësaj përqasjeje, çdo formë përdorimi dhe nxënieje e një gjuhe mund të përkufizohet si më poshtë:

“Përdorimi i një gjuhe, duke përfshirë edhe nxënien e saj, përfshin veprime të kryera nga nxënësi, i cili si individ dhe si aktor shoqëror zhvillon një numër kompetencash kyç dhe në veçanti kompetencën e komunikimit gjuhësor. Nxënësi vë në zbatim kompetencat që zotëron në kontekste dhe kushte të ndryshme (situatat e të nxënit) dhe kalon vështirësitë për t’u përfshirë në veprimtari gjuhësore. Këto veprimtari përfshijnë proceset gjuhësore, të cilat mundësojnë kuptimin dhe prodhimin e teksteve që lidhen me tema dhe fusha specifike duke mobilizuar strategjitë më të përshtatshme për përmbushjen e detyrave që duhen realizuar. Monitorimi i këtyre veprimeve nga vetë nxënësi, çon në përforsimin ose përmirësimin e kompetencave kyç.”

Kjo përqasje ilustron në figurën e mëposhtme.



b. Tematikat që trajtohen në lëndën e “Gjuhës së huaj” janë të larmishme dhe mbulojnë të gjitha fushat e jetës

- **Jeta e përditshme** (organizimi i një plani ditor dhe i kohës së studimit; kujtime të mrekullueshme- dita më e bukur e jetës sime; qëllimet afatshkurtër dhe afatgjatë; çfarë dua unë për të ardhmen time etj.).
- **Bota e shkollës dhe e punës** (organizimi i një biznesi të vogël; shqetësimet e shoqërisë së sotme si papunësia etj.; studimet dhe universitetet në vend dhe në botë etj.).
- **Jeta personale dhe shoqërore** (shanse dhe të drejta të barabarta për gratë dhe burrat, të rinjtë dhe të rriturit; vendlindja; personalitete në shoqëri etj.).
- **Bota rreth nesh** (arti në shekuj; e ardhmja, flora dhe fauna; historia e filmit; programet televizive; zakonet dhe traditat në vendet ku flitet gjuha që po mësohet; momente të rëndësishme të historisë botërore; personalitete në fusha të ndryshme të jetës etj.).
- **Bota e komunikimit** (bota e teknologjisë; rrjetet sociale; të shkruarit e letrave (letër kërkesë, letër ankesë, letër biznesi, ese etj.).

Realizimi i kompetencave kyç gjatë procesit të të nxënës kërkon që mësuesi të lidhë kompetencat kyç me kompetencat specifike të lëndës. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë metodat, teknikat dhe mjetet e përshtatshme didaktike për realizimin e çdo kompetence dhe rezultati të të nxënës. *Kompetenca përcaktohet si harmonizim i njohurive, shkathtësive, vlerave dhe qëndrimeve për të trajtuar plotësisht situatat e kontekstit.* Kur nxënësi punon për të përmbushur kompetencat gjuhësore, ai njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyç.

Mësuesi gjatë procesit të planifikimit të periudhave mësimore si edhe planifikimit ditor duhet të jetë shumë i kujdesshëm në përcaktimin e rezultatit/eve të të nxënës për kompetencat kyç që synon të arrijë nxënësi në shkallën dhe klasën përkatëse. Mësuesi duhet t'i përshtatë ato me rezultatet e të nxënës të kompetencave të lëndës duke përzgjedhur dhe përdorur përmbajtjen mësimore, mjetet didaktike dhe metodologjinë e duhur përmes të cilave të realizojë sa më mirë këto rezultate.

Shembujt e mëposhtëm të zhvillimit të kompetencave kyç nëpërmjet zhvillimit të kompetencave dhe njohurive të marra në lëndën e gjuhës së huaj nuk janë shteruese. Ato pasurohen nga vetë mësuesit.

1. Kompetenca digjitale dhe gjuha e huaj

Gjatë prezantimeve të ndryshme në orën e gjuhës së huaj, nxënësi jo vetëm zhvillon kompetencën pragmatike (zhvillimi i temës, lidhja logjike e ideve, koherenca e mendimeve), por ai përdor edhe mjetet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit duke ndihmuar në zhvillimin e kompetencës digjitale.

Mësuesi në lëndën e “Gjuhës së huaj” mund të planifikojë veprimtari dhe ushtrime të ndryshme, ku nxënësi përveç të mësuarit të gjuhës, të jetë në gjendje të zhvillojë kompetencën digjitale. Shembull

Një nga rezultatet e kompetencës digjitale për klasën XII (shkalla 6) është: “Nxënësi vlerëson cilësinë e informacionit që gjen nga një shumëllojshmëri burimesh në internet.” Mësuesi këtë rezultat mund ta realizojë në një orë diskutimi. Një orë më parë mësuesi ka ndarë klasën në grupe dhe secilit grup i ka dhënë disa faqe interneti për t'i vlerësuar (p.sh. Grupi A: <http://.youtube.com/> Grupi B: <http://exploratorium.com> <http://planplanet.org> etj, sipas kriterëve të dhëna në tabelën e mëposhtme e cila është plotësuar si shembull për faqen <http://www.britannica.com>.

Accuracy and acceptance	Trustworthy publisher, content written by experts in their field.
Authority and coverage	Authoritative author. Does not have the coverage of user-generated encyclopedias.
Audience and relevance	Aimed at English speaking adult readers.
Educational focus	Explicit educational focus but does not link to curriculum. Very text heavy.
Ease of use	Internet search engine. Navigation is a little complicated.

Pasi kanë plotësuar tabelat për faqet e dhëna, nxënësit diskutojnë në grup për avantazhet dhe disavantazhet e secilës prej tyre si edhe mbështesin me argumente se cila është faqja e tyre e preferuar.

2. Kompetenca e të menduarit dhe gjuha e huaj

Rezultatet e të nxënit të kompetencave në lëndën e “Gjuhës së huaj”, pasqyrojnë të njëjtën qasje me rezultatet e të nxënit të kompetencave kyç në këndvështrimin e domosdoshmërisë së tyre në jetë, shoqëri dhe punë.

Shembull

Një nga rezultatet e kompetencës kyç të të menduarit për klasën XII (shkalla 6) është: *“Nxënësipërpunon në mënyrë kritike informacionet e mbledhura nga burime të ndryshme për ndonjë temë të ndjeshme në shoqëri, formon qëndrim kritik dhe e paraqet atë gjatë një debati me moshatarët dhe me të tjerët për çështjen e ngritur, “pro” ose “kundër” (martesat mes anëtarëve të një gjinie, dënimi me vdekje etj.).”*

Mësuesi këtë rezultat mund ta realizojë (a) në një orë debati ku nxënësve u është dhënë paraprakisht tema dhe pasi ata kanë mbledhur informacionin e duhur, diskutojnë në klasë dhe mbajnë qëndrimet e tyre pro/kundër ose (b) gjatë një ore ku zhvillohet aftësia e të shkruarit, mësuesi jep një temë eseje dhe nxënësit mbajnë qëndrimin e tyre duke dhënë argumente të mbështetur me shembuj konkretë të gjetur nga jeta e përditshme ose burimet e ndryshme të informacionit.

3. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen, mjedisin dhe gjuha e huaj.

Në programin e klasës XI (shkalla 5) një nga rezultatet e të nxënësve të kompetencës përjetën, sipërmarrjen dhe mjedisin (kompetencë kyç) është: *“Nxënësi harton një projekt me fazë të menaxhuara mirë (individualisht ose në grup) duke shkëmbyer, konsultuar dhe informuar të tjerët, si dhe duke identifikuar dhe duke vlerësuar burimet njerëzore, materiale dhe informative, në përputhje me rezultatet e pritshme.”.*

Shembull

Për përmbushjen e këtij rezultati mësuesi shfrytëzon orët e projektit dhe që në fillim të vitit shkollor, pasi klasa është ndarë në grupe, u kërkon nxënësve të hartojnë një plan studimi dhe veprimi për secilin anëtar të grupit. Plani paraqitet në klasë me afat kohor, përgjegjësi për secilin anëtar, si edhe rezultatet e pritshme. Mësuesi kërkon respektimin e tij dhe monitoron gjithë procesin pasi kjo do të jetë pjesë e vlerësimit final të projektit.

4. Kompetenca personale dhe gjuha e huaj

Në programin e klasës XI (shkalla 5) një nga rezultatet e të nxënësve të kompetencës personale (kompetencë kyç) është: *“Nxënësi analizon veprimet e veta dhe të kolegëve gjatë një situatë konflikti, duke propozuar alternativa për zgjidhjet e drejtpërdrejta papasojaduke ndarë përvojat, mendimet dhe ndjenjat me anëtarët e grupit.”.*

Shembull

Mësuesi ndihmon nxënësin për përmbushjen e këtij rezultati kur harton dhe planifikon situatën e ndryshme të nxënësit për temën e caktuar. P.sh, kur zhvillohet tema “Shkolla-studimet

universitare”, mësuesi krijon një situatë ku në një familje të përbërë nga gjyshërit, prindërit dhe dy fëmijë, fëmija më i madh kërkon të studiojë jashtë shtetit. Në familje ka debat dhe secili jep argumente të ndryshme (të qenurit larg familjes, situata financiare, të qenurit i pavarur etj.) dhe në fund familja duhet të dalë me një vendim. Mësuesi ndihmon nxënësit me fjalorin dhe me struktura të larmishme formulimi fjalish.

5. *Kompetenca qytetare dhe gjuha e huaj*

Në programin e klasës X (shkalla 5) një nga rezultatet e të nxënës të kompetencës qytetare (kompetencë kyç) është: *“Nxënësi shpreh mendimin dukekërkuar paraprakisht lejengagrupi, respekton mendimin esecilit anëtarëtgrupit dukei dëgjuar nëmënyrë aktive, vendosdukebashkëpunuarmetëgjithë anëtarët, për mënyrat që çojnëdrejtpërfundimit të një aktiviteti të caktuar.”*

Shembull

Mësuesi së bashku me nxënësit që në fillim të vitit shkollor vendosin rregullat që nxënësit do të ndjekin gjatë diskutimeve në grup. Për këtë arsye ata mund edhe të krijojnë një listë rregullash të shoqëruara me fjalët kyç në gjuhën e huaj që po mësojnë, të cilat mund t'i pasurojnë gjatë vitit si edhe në vitet në vazhdim. Respektimi i rregullave dhe përdorimi i fjalorit të duhur në çdo situatë e ndihmon nxënësin jo vetëm të forcojë kompetencën qytetare, por edhe kompetencën e komunikimit dhe të shprehurit.

Gjithashtu, e parë në kontekstin e anasjelltë, nxënësi ndihmohet nga kompetencat kyç për të përmbushur sa më mirë kompetencat specifike të lëndës dhe për të realizuar veprimtaritë gjuhësore. Si p.sh., në varësi të tekstit që nxënësi lexon, ai nuk bazohet vetëm te kompetenca gjuhësore, por edhe te kompetenca e të menduarit ose ajo qytetare. Në një rast tjetër nëse nxënësi lexon një tekst si pjesë e një programi të të mësuarit, ai bazohet te kompetenca e të mësuarit për të nxënë.

IV. INTEGRIMI NDËRLËNDOR

Gjuha e huaj e pajis nxënësin me njohuri, aftësi dhe shkathtësi që sigurojnë suksesin e tij edhe në fushat dhe lëndët e tjera. Kompetencat gjuhësore janë kompetenca që ndihmojnë nxënësin në procesin e të nxënës në të gjitha fushat kurrikulare. Konceptet e njohuritë gjuhësore trajtohen e mësohen më mirë në kontekste të caktuara kuptimore dhe ligjërimore, të cilat lidhen ngushtë me fusha tematike të parashtruara në programin e gjuhës së huaj dhe të trajtuara në lëndët e tjera, duke e ndihmuar nxënësin të zgjerojë fjalorin dhe të zhvillojë

aftësinë e të shprehurit qartë me shkrim dhe me gojë. Duke përvetësuar aktet dhe funksionet gjuhësore, nxënësi mëson si të komunikojnë me të tjerët në mënyrë korrekte dhe gramatikisht të saktë.

Më poshtë po renditim disa shembuj të integritit ndërlëndor të cilët nuk janë shteruese dhe pasurohen nga vetë mësuesit në punën e tyre të përditshme sipas situatave të krijuara në çdo orë mësimi:

1. Gjuha e huaj dhe letërsia

Gjuha e huaj i mundëson nxënësit që të kuptojë dhe analizojë tekste ose mesazhe të ndryshme. Leximi dhe analiza e teksteve letrare ndikon në të kuptuarin e ngjarjeve, marrëdhënieve dhe figurave historike si dhe vlerave shoqërore.

Shembull

Nxënësit në klasë të XI dhe XII në gjuhë të huaj mësojnë të shkruajnë ese argumentuese. Mësuesi pasi shpjegon strukturën e esesë dhe pasi ka marrë informacion nga nxënësit se si trajtohen esetë argumentuese në gjuhën shqipe, u cakton detyrë atyre të shkruajnë një ese mbi avantazhet dhe disavantazhet e periudhave të ndryshme në historinë e letërsisë botërore (Rilindja, Mesjeta etj.) duke marrë shembuj nga autorët që po studiojnë në lëndën e letërsisë.

2. Gjuha e huaj, historia dhe gjeografia

Duke lexuar tekste të fushave të ndryshme (*histori, gjeografi, qytetari* etj), nxënësi zgjeron njohuritë për atë fushë dhe gjithashtu fiton njohuri mbi vendet ku flitet gjuha e huaj, të cilën po mëson. Këto njohuri ndërthuren me dijet mbi kulturën e këtyre vendeve, zakonet e doket e tyre, mënyrën e jetesës etj. Nxënësi mëson të ndërveprojë në situata të ndryshme me sjellje etike të përshtatshme, të cilat trajtohen përmes funksioneve gjuhësore, si: të kërkojë falje, të pyesë etj.

Shembull

Kur në lëndën e “Gjuhës së huaj” trajtohet tema: “Jeta e personaliteteve të shquara”, mësuesi pyet nxënësit se cilën periudhë të historisë janë duke studiuar dhe inkurajon nxënësit që të prezantojnë jetën dhe veprimtarinë e njerëzve të shquar të vendit dhe periudhës historike që ata janë duke trajtuar në lëndën e historisë. Në këtë mënyrë nxënësit shfrytëzojnë materialet e lëndës së historisë, bëjnë punë kërkimore, por dhe zgjerojnë më tej njohuritë e tyre të përgjithshme gjuhësore.

3. Gjuha e huaj dhe lëndët e fushës “Shoqëria dhe mjedisi”

Me fushën “*Shoqëria dhe mjedisi*” janë të lidhura tema si: miqësia, marrëdhëniet familjare, marrëdhëniet në shkollë, koha e lirë, festat, ndotja, mbrojtja e ambientit etj, të cilat rekomandohen në Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët. Këto tema shoqërohen me fjalor e struktura gjuhësore, të cilat trajtohen jo si një qëllim në vetvete, por në një kontekst kuptimplotë dhe edukativ në lidhje me nivelin përkatës.

Shembull

Mësuesi rekomandohet që temat e jetës së përditshme t’i përdorë gjithmonë në fillim të orës së mësimi duke u drejtuar nxënësve pyetje të cilat çojnë tek njohuritë e reja që mësuesi do të prezantojë. Nëse tema e re që do prezantohet është “Jeta në komunitet”, mësuesi fillon me pyetje si: “Si do ta përshkruanit lagjen ku jetoni? A ju pëlqen ajo? Si do e donit ndryshe?” etj, dhe më pas ndihmon dhe monitoron nxënësit të punojnë me tekstin e ri. Mësimi vazhdon me një (a) diskutim ku nxënësit në grupe shprehin mendimet e tyre se si do të donin të ishte lagja e tyre ose me (b) lojë me role ku nxënësit improvizojnë një emision televiziv dhe marrin rolet e drejtuesit të emisionit, përfaqësuesit të bashkisë, përfaqësuesit të komunitetit, të analistëve etj.

4. Gjuha e huaj dhe biologjia

Në lëndën e biologjisë, lidhja bëhet e qartë duke trajtuar tema, si: pjesët e trupit, ushqyerja, shëndeti dhe mjedisi.

Shembull

Ngrohja globale, të jetuarit miqësisht me ambientin, janë tema që trajtohen pothuajse në të gjitha tekstet e gjuhëve të huaja. Në trajtimin e këtyre temave mësuesi krijon situata reale të nxëni. Nxënësve u kërkohet të bëjnë një studim mbi ndotjen (ndotja e ajrit, akustike, e ambientit etj.) në komunitetin ku jetojë duke analizuar shkaqet, pasojat dhe prezantuar rekomandimet për një ambient sa më të pastër. Ata gjithashtu hartojnë pyetësorë dhe realizojnë intervista me banorët dhe bizneset e komunitetit. Një grup tjetër nxënësish zhvillojnë një fushatë ndërgjegjësimi (online ose me postera dhe fletëpalosje) për promovuar të qenit miqësorë me ambientin.

5. Gjuha e huaj dhe matematika

Integrimi i gjuhës së huaj me lëndët brenda fushës si edhe të fushave të tjera ndihmon jo vetëm në lidhjen ndërlëndore, por edhe në pasurimin e një leksiku më specifik dhe përdorimin e tij në jetën e përditshme. Lidhja me “*Shkencat natyrore*” p.sh., matematika me

gjuhën e huaj shprehet në të mësuarin e numrave, veprimeve matematikore (mbledhja e zbritja, shumëzimi dhe pjesëtimi).

Shembull

Një detyrë projekti shumë interesante që mund t'ju jepet nxënësve është të hartojnë një plan mujor për një jetesë të shëndetshme. Nxënësit duhet të përdorin jo vetëm njohuritë që kanë në lëndën e “Edukimit fizik” (planifikimi i llojeve të ndryshme të veprimtarive sportive), në lëndën e biologjisë (vlerat ushqimore të frutave dhe perimeve), në lëndën e informatikës (kërkimi dhe përzgjedhja e informacionit të duhur në internet), por edhe njohuritë që kanë marrë në lëndën e matematikës (duke llogaritur kaloritë që do t'u duhen të harxhojnë çdo ditë ose kaloritë që do marrin nga ushqimi). Gjithashtu nxënësit pasurojnë fjalorin në gjuhë të huaj me fjalë dhe struktura të reja. Mësuesi monitoron gjithë procesin dhe ndihmon me fjalorin e ri.

6. Gjuha e huaj dhe TIK

Lidhja me lëndën e TIK-ut, përmes së cilës nxënësi aftësohet të përdorë internetin, e-mail-in, programe të ndryshme, platforma digjitale, aplikacione etj, jo vetëm që e ndihmon nxënësin të marrë informacionin në kohë reale, por gjithashtu e ndihmon atë të eksplorojë të reja mbi botën dhe lëndën që ai po studion, të prezantojë sa më bukur dhe në mënyrë logjike idetë dhe opinionet e tij.

Shembull 1

Mësuesi teston të kuptuarin e asaj që nxënësit lexojnë duke përzgjedhur materiale leximi në internet dhe harton një ushtrim me fjali të vërteta ose të gabuara rreth atyre materialeve. Nxënësve u kërkohet të shkojnë tek www.google.com dhe të kërkojnë fjalën wiki- Define: wiki. Gjithashtu u kërkohet të shohin një shembull wiki në:

<http://thisisanexamplewiki.pbworks.com/> si edhe çfarë shkruhet në Wikipedia për wiki.

Nxënësit pasi lexojnë materialet e dhëna zgjidhin ushtrimin e mëposhtëm dhe gjejnë nëse fjalitë janë të vërteta ose të gabuara:

No	Statement	True	False
1	Wikis are usually written by one person.		
2	Wikis are always web based.		
3	The readers of the site can edit the content, making changes to what has previously been written by other readers.		
4			

Pas plotësimit të tabelës dhe diskutimit të pyetjeve, mësuesi u sugjeron nxënësve të përdorin wikis kur u duhet të shkruajnë një material në grup, ose kur u kërkohet të korrigjojnë detyrën e shokut.

Shembull 2

Jepuni nxënësve në grupe të vogla të eksplorojnë një mjet teknologjik dhe të përcaktojnë si mund të përdoret ai në orën e mësimit. Hapi i dytë do të jetë që secili grup të prezantojë para klasës mënyrat e përdorimit. Në këtë mënyrë mësojnë jo vetëm nxënësit e tjerë, por edhe ju si mësues. Gjatë kësaj veprimtarie shpjegojuni nxënësve hapat që duhet të ndjekin gjatë prezantimit dhe këshillojini të jenë të durueshëm dhe të përpiqen të monitorojnë bashkëmoshatarët e tyre. Shpjegimet që japin nxënësit duhet të jenë të thjeshta për t'u kuptuar dhe mundësisht t'u jepet një format i cili duhet të ndiqet nga të gjithë përfaqësuesit e grupeve që do prezantojnë:

1	Së pari, klikoni në _____. (p.sh., Projekti i Ri)
2	Së dyti, shkoni në këndin e sipërm në të djathtë të ekranit dhe klikoni në _____ (Zgjidhni Sfondin)
3	Së treti, shikoni paraprakisht _____. (Opsionet e sfondit)
4	

Një tjetër mundësi është që të mësohet paraprakisht fjalori i nevojshëm dhe gjuha funksionale në mënyrë që nxënësit prezantues të mund të japin udhëzime të qarta. Kërkojuni nxënësve të përfshihen në stuhi mendimesh, duke përdorur të menduarit krijues dhe kritik rreth mënyrave më të mira për të hartuar udhëzime sa më të qarta për t'u kuptuar për mjetin teknologjik që ata do të prezantojnë.

7. Gjuha e huaj dhe artet

Tema të tilla si sporti, muzika, moda, piktura etj., janë të lidhura ngushtë me fushën e arteve ku nxënësit shkruajnë dhe diskutojnë rreth biografisë ose karrierës së aktorëve, sportistëve etj. të tyre të preferuar. Mësuesi sugjerohet të fillojë orën e mësimit me diskutime rreth zhvillimeve më të fundit në fushën e artit, kulturës dhe sportit në vend dhe botë.

Shembull

Krijimi i situatave reale të të nxënës ndihmojnë nxënësit që jo vetëm të integrohen në orën e mësimit, por edhe të mësojnë nga njëri-tjetri dhe të krijojnë dije të qëndrueshme. Në temën “Koha e lirë” mësuesi mund të krijojë situatën: Shkolla jonë do që të krijojë disa klube

artistike dhe sportive pas mësimit (klubi i dramës, pikturës, shahut, fotografisë, filmit, futbollit etj.). Në grupe:

- diskutoni se cilët mund të jenë të suksesshëm dhe pse, duke dhënë argumentet tuaja;
- vendosni në grup për në cilat klube do të dëshironit të ishit;
- hartoni një plan veprimtarish për klubin që ju mendoni se do të jetë më i kërkuar nga nxënësit;
- krijoni një poster për promovimin e klubit tuaj të preferuar.

Kjo situatë mund të zgjerohet dhe të jetë edhe temë projekti, ku nxënësit përfundojnë me prezantimin e një dramatizimi, filmi, foto, kolazh etj., të krijuara nga vetë nxënësit, duke shpjeguar në gjuhë të huaj hapat, teknikat, veprimtaritë që ndoqën dhe realizuan.

V. TEMAT NDËRKURRIKULARE

Temat ndërkurrikulare janë tema madhore me të cilat përballet shoqëria tani dhe në të ardhmen. Gjuha e huaj ka një shumëllojshmëri zbatimesh në jetën e përditshme dhe është e lidhur me shumë komponentë të arsimit. Kjo lidhje është e dyfishtë, sepse ajo jo vetëm merr në konsideratë shumë nga këta komponentë, por edhe kontribuon në realizimin e tyre. Kështu, në shqyrtimin e temave ndërkurrikulare (Identiteti kombëtar dhe njohja e kulturave; Të drejtat e njeriut; Vendimmarrja morale; Zhvillimi i qëndrueshëm; Mjedisi; Ndërvlerësim; Bashkëjetesa paqësore.) nxënësi duhet të zgjidhë situata dhe probleme duke marrë pjesë në diskutime dhe debate, duhet të përdorë aftësitë e të menduarit kritik dhe pyetje të nivelit të lartë si dhe të jetë në gjendje të shprehë mendimin e tij duke u mbështetur në fakte dhe argumente, aftësi që i mëson dhe i zhvillon në lëndën e gjuhës së huaj. Përmes situatave të paraqitura në temat ndërkurrikulare, nxënësi ka mundësi të bëjë lidhjet ndërmjet kompetencave komunikative me detyrat e caktuara për realizimin e këtyre temave. Nxënësi mëson të realizojë disa etapa, kur zgjidh një problem apo situatë dhe kjo aftësi kontribuon në rritjen e tij personale duke e ndihmuar atë të gjejë vendin e tij në shoqëri. Nxënësi mund të përdorë anketa, intervista për të bërë analiza rreth mendimit të njerëzve, mund të arsyetojë dhe të argumentojë një vendim të caktuar. Kështu, ai mëson të marrë pjesë në jetën shoqërore në klasë dhe në shkollë, zhvillon një qëndrim të hapur ndaj botës duke respektuar diversitetin.

1. Zhvillimi i qëndrueshëm

Mësuesi shpesh shqetësohet pasi nuk është ekspert në çështjet e mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm dhe nuk beson se mund të trajtojë çështje të tilla sidomos në klasa me një nivel

të ulët gjuhësor. Kjo nuk duhet të jetë një shqetësim për mësuesin, pasi ai është ekspert në gjuhën e huaj.

Shembull

Në një orë mësimi me temë “Teknologjia dhe ne”, mësuesi ndan klasën në grupe, ju tregon nxënësve telefonin e tij celular dhe kërkon që t`ju përgjigjen pyetjeve: “Ku mendoni se është prodhuar ky telefon? Çfarë do bëj unë me këtë telefon kur ai të prishet? etj.” Mësuesi u jep kohë nxënësve të krijojnë një historik të telefonit të tij dhe u kërkon të jenë krijues. Më pas mësuesi i vendos nxënësit në grupe të tjera dhe ata krahasojnë përgjigjet e tyre. Mësuesi pyet nxënësit se cili është ndikimi i telefonave celularë ndaj ambientit dhe si mundemi ne ta zvogëlojmë këtë ndikim. Në këtë mënyrë mësuesi ka ndërgjegjësuar nxënësit për ambientin në të cilin jetojmë dhe zhvillimin e qëndrueshëm, duke i fuqizuar ata të jenë të aftë të marrin pjesë në diskutime dhe debate dhe të jenë pjesë e zgjidhjeve të problemeve të ndryshme.

Pas këtij diskutimi, mësuesi vazhdon me tekstin dhe ushtrimet që janë në libër.

2. Të drejtat e njeriut

Edukimi për të drejtat e njeriut zë një vend shumë të rëndësishëm edhe në lëndën e gjuhëve të huaja. Mësuesi duhet të punojë për ndërgjegjësimin e nxënësve duke planifikuar veprimtari të cilat synojnë pajisjen e nxënësve me njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e duhura për të kontribuar në ndërtimin dhe mbrojtjen e një kulture universale të të drejtave të njeriut në shoqëri.

Shembull

Në një orë mësimi në gjuhën angleze me temë “My family”, mësuesi mund të organizojë orën e të folurit (*speaking*) në këtë mënyrë:

- Ask students to brainstorm some important decisions a family has to make that affect all its members.
- Next to each decision, write whether it is made mainly by men, women or a combination.
- Discuss the differences in the kinds of decisions that males and females make in the family.
- Next ask students to list some important decisions affecting the whole population that were made in their community in the last few years (e.g. starting a new club or team, building or closing a hospital, allotting land, increasing bus fares).

Assign each small group one of these decisions to analyze:

- What are the gender implications of these decisions? Do they have any particular impact on women and girls? On men and boys?
- Next to each decision, write the name of the body that made the decision and the approximate percentage of males and females in that body.
- How might the decision be different if the decision making body were composed of an equal number of males and females?

VI. METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIE – NXËNIES NË GJUHËN E HUAJ

Metodat e mësimdhënies janë mjaft të rëndësishme për të realizuar një mësimdhënie efektive. Përdorimi i tyre shërben për zhvillimin gjuhësor të nxënësve dhe konsolidimin e kompetencave kyç dhe ato të lëndës. Mësuesit duhet të përditësojnë njohuritë rreth metodave, teknikave dhe strategjive të mësimdhënies me qëllim që të zhvillojnë tek nxënësi dëshirën për dijen, vlerëtojnë njerëzore, ambicien për të qenë i suksesshëm dhe aktiv në jetën epërditshme dhe botën e punës.

Ky përditësim do t'i ndihmojë mësuesit gjithashtu për të reflektuar rreth mësimdhënies së tyre si edhe të vlerësojnë pikat e tyre të forta dhe të dobëta. Mësuesit që njohin dhe përdorin teknika të ndryshme në orën e mësimi, pa dyshim janë shumë efektivë, si edhe adoptohen më lehtë me nevojat e nxënësve dhe me situata të ndryshme me të cilat mund të ndeshen në klasë.

Një nga kompetencat kyç në kurrikulën me bazë kompetencat, është kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit. Kjo sjell si detyrë kryesore të çdo mësuesi të gjuhës së huaj, që duke mos lënë mënjane metodat e mëparshme që ka përdorur (Grammar Translation Method, Audio- Lingual Method, Total Physical Response Method etc), të përdorë gjerësisht metodën komunikative në mësimdhënie (Communicative Language Teaching Method). Qëllimi i kësaj metode është që në orën e mësimi gjuha që përdoret të jetë sa më afër gjuhës që përdoret në jetën e përditshme. Kjo do të thotë që mësuesi duhet t'i mësojë nxënësit jo “si të flasin”, por “çfarë të flasin” dhe “kur të flasin”.

Disa tipare të kësaj metode janë:

- mësuesi dhe nxënësit përdorin gjuhën që po mësojnë gjatë orës së mësimi;
- gjuha që nxënësit po mësojnë është një mjet për komunikimin në klasë rreth problemeve dhe çështjeve reale të jetës së përditshme;

- funksionet gjuhësore që mësohen përdoren në situata të nxëni të shumëllojshme dhe reale;
- veprimtari të përditshme janë puna në çift, puna me role dhe lojërat, pasi ato ngjasojnë me botën reale (gjuha që përdoret duhet të ketë një qëllim);
- theksi vendoset në diskutimin e situatave reale ku shprehjet dhe fjalori i ri që po jepet është i përshtatshëm për këto situata;
- gabimet konsiderohen të natyrshme dhe të pranueshme.

Nxënësit mësojnë në mënyra të ndryshme; disa mësojnë më mirë kur shkruajnë, disa kur flasin dhe diskutojnë, të tjerët kur lexojnë ose dëgjojnë. Shumica e nxënësve mësojnë kur i kombinojnë të gjitha këto aftësi. Nxënësit ndryshojnë shumë nga njëri-tjetri, por dy faktorë duket se janë universalë. Nxënësit mësojnë kur (a) motivohen dhe (b) kur nuk kanë ankth.

Tabela e mëposhtme jep veprimtari të ndryshme që mund të përdoren me nxënës të ndryshëm.

Nxënësi dinamik	Nxënësi me imagjinatë	Nxënësi analitik	Nxënësi praktik
Përshkrimi			
Nxënësi është i interesuar të zbulojë vetë informacionin dhe i pëlqejnë metoda të ndryshme në orën e mësimi; mëson duke provuar dhe gabuar.	Nxënësi i pëlqen diskutimi, puna në grup, jep feedback realist rreth ndjenjave dhe përdor imagjinatën e tij në trajtimin e problemeve; mëson duke dëgjuar dhe duke shkëmbyer ide.	Nxënësi është i interesuar në fakte; i pëlqejnë detajet dhe mendimi i organizuar; mëson më mirë kur i trajton problemet nëpërmjet ideve.	Nxënësi është i interesuar se si funksionojnë gjërat; i pëlqejnë gjërat teknike dhe aktivitetet praktike; mëson më mirë kur i aplikon teoritë në praktikë.
Llojet e veprimtarive			
- shkrim letrash; - përgatitje posterash; - lojëra të ndryshme; - fjalime; - pjesëmarrje në skenarë të ndryshëm në lojë me role;	- diskutim rreth përvojave personale; - diskutim rreth pikturave, posterave, vizatimeve etj.; - stuhi mendimesh; - të dëgjuarit; - të kënduarit e një kënge; - intervistat;	- analizë faktesh; - leksione; - marrje shënimesh; - ushtrime të kontrolluara; - lexim në qetësi; - diktime; - analizë diagramesh, tabelash etj.	- formulim pyetjesh rreth mësimi; - ushtrime që kërkojnë aftësi të menduarit kritik; - ushtrime me alternativa/kombini me; - diskutime në çift ose në grup;

- publikim i punimeve të nxënësve - organizimi i ekskursioneve tematike; - intervista; - pyetësorë dhe vëzhgime.	- leximi i një artikulli të shkurtër gazete, tekst kënge/ poemë, - shkëmbimi i një modeli detyre.		- planifikimi i projekteve; - ushtrime me hapësira bosh; - tregime të animuar; - krijim diagramesh, tabelash etj.
---	--	--	--

Mësuesit gjithashtu duhet të marrin në konsideratë stilet e të nxënësve dhe veprimtaritë që lidhen me secilin prej tyre.

Stili i të nxënësve	Karakteristikat	Veprimtaritë që rekomandohen
Vizual (vizual)	Nxënësi: - preferon të përdorë imazhe, foto, vizatime, harta, grafikë për të kuptuar informacionin e ri; - përdor shprehje “më trego...”, “le të shikojmë ...”; - e kryen detyrën më mirë pasi ka parë udhëzimet ose pasi shikon një person tjetër p - që performon më përpara.	- Përdorimi i hartave, grafikëve për prezantimin e njohurive të reja. - Nënvizimi i koncepteve të reja. - Përdorimi i listave, flash cards për rimarrjen e njohurive. - Përdorimi i figurave për prezantimin e fjalëve të reja. - Shkrimi në dërrasë i informacionit dhe koncepteve kryesore. - Nëse punon në kompjuter, të rekomandohet të përdorë fonte dhe ngjyra të ndryshme në organizimin e informacionit.
Auditiv (auditory)	Nxënësi: - kupton informacionin e ri më mirë kur e dëgjon ose kur e diskuton në grup; - përdor përsëritjen si një teknikë e të nxënësve dhe përfiton nga përdorimi i teknikave të të mbajturit mend	- Përfshirja e nxënësit në diskutime rreth temës së dhënë. - Pyetje për nxënësit rreth materialit. - Nxënësit bëjnë përmbledhjen e mësimit. - Inkurajimi i nxënësve të regjistrohen kur mësojnë njohuritë dhe konceptet

	(mnemonic devices); - përdor shprehje si “le ta bisedojmë ...”, “le të flasim rreth...”; - kryen detyrën më mirë kur i jepen udhëzime me gojë.	e reja. - Leximi i tekstit me zë të lartë. - Nxënësve u sugjerohet të lexojnë disa herë me zë të lartë. -
Kinestetik (prekshmëria) (kinesthetic/tactile)	Nxënësi: - kupton informacionin e ri më mirë kur i prezantohet nëpërmjet lëvizjes; - mëson më mirë kur e krijon vetë një detyrë dhe ka preferencë për përvoja fizike; - përdor shprehje si “le ta provojmë...”, “Si ndjeheni?”; - kryen detyrën më mirë kur provon vetë dhe mëson duke bërë; - pëlqen eksperimentet dhe nuk i referohet udhëzimeve.	- Dhënia e listës së materialeve që do duhen për një veprimtari. - Përdorimi i llojeve dhe formateve të ndryshme fletë pune, lapsash etj. - Përdorimi i koncepte të punës me role ose në grup. - Prezantimi i konceptit të ri nga nxënësi nëpërmjet lëvizjes. - Krijimi nga nxënësit i skenareve për përdorimin e koncepteve të reja. - Vendosja e nxënësve në role të ndryshme. - Inkurajimi i nxënësve për të përdorur lëvizjet trupore kur mëson koncepte të reja.
Linguistik/ verbal (read and write)	- preferon të lexojë dhe të shkruajë; - prezanton veten si adhurues i të lexuarit dhe që mban shumë shënime; - është në gjendje të shpjegojë konceptet abstrakte me fjalë ose edhe të shkruajë ese; - mëson më mirë kur i jepen ushtrime që kanë të bëjnë me arsyetimin gjuhësor.	- Organizimi i lojërave gjuhësore. - Projekte të bazuara në të shkruarin. - Caktimi i detyrave që fokusohen tek analiza letrare e tekstit. - Vizita në librari, bibliotekë. - Nxënësit inkurajohen të hartojnë fjalorët e tyre. - Nxënësit tregojnë histori që kanë lexuar. - Punimi i ushtrimeve me fjalorin dhe të lexuarin e tekstit.

Mësuesi në punën e tij duhet të përdorë veprimtari, teknika dhe strategji të larmishme për t'ju përshtatur stileve të ndryshme të të nxënës dhe duke e bërë orën e mësimit sa më interesante dhe motivuese për nxënësin.

Më poshtë po listojmë disa teknika dhe aktivitete të ndryshme të cilat mund të përdoren në orën e mësimit:

1. *Eliciting*

Eliciting (nxjerrja e informacionit nga vetë nxënësit) është një term që përfshin disa teknika të cilat e aftësojnë mësuesin për të inkurajuar nxënësit të japin vetë informacion duke mos e marrë atë gati nga mësuesi.

Eliciting ndihmon për të pasur një klasë me në qendër nxënësin dhe krijimin e njohurive të reja mbi njohuritë që nxënësi ka. Eliciting është një teknikë bazë që duhet të përdoret rregullisht dhe jo vetëm në fillim të orës së mësimit, por kurdo që është e domosdoshme. Çelësi i suksesit i kësaj teknike është komunikimi sa më i mirë midis mësuesit dhe nxënësit. Mësuesi mund të marrë informacion nga nxënësit (elicit) për çdo gjë në orën e mësimit: fjalor, gramatikë, përvoja, ide etj.

Disa mënyra efektive për të marrë informacion nga nxënësit (eliciting):

Shembull

- a. Mësuesi pyet: “What is another way to say _____? Si mund ta themi ndryshe _____? (T:” What is another way of saying I am very very hungry?” S:” I am starving.”)
- b. Nëse nxënësi nuk e di fjalën e re, mësuesi jep një përkufizim të thjeshtë të asaj fjale: “It is something that we drink hot coffee and tea with (a mug)”
- c. Mësuesi përdor lëvizje dhe mimikën për shpjegimin e fjalëve.
- d. Mësuesi përdor mjete vizuale.

2. *Dialogu*

Nëpërgjithësi dialogu përdoret për të ndihmuar nxënësin të mbajë mend struktura të reja dhe fjalorin e sapo mësuar. Dialogu mund të merret nga teksti, mund ta ketë përgatitur mësuesi ose vetë nxënësit, duke ndjekur një model të dhënë.

Shembull

- a. Nxënësit lexojnë dialogun në qetësi.
- b. Në çifte ose në grupe nxënësit praktikojnë dialogun në fillim duke lexuar dhe më pas duke e mbajtur mend.

- c. Nxënësit e zgjerojnë ose e ndryshojnë dialogun duke e përshtatur sipas situatave të tyre personale.

3. Loja me role

Nxënësit marrin role të ndryshme dhe më pas u jepet kohë të mendojnë duke pretenduar se janë personazhi, rolin e të cilit kanë marrë. Kjo teknikë përdoret për të ndihmuar nxënësin që ta konsiderojë një problem nga këndvështrime të ndryshme. Loja me role mund të funksionojë shumë mirë duke pasuar dialogun, ku nxënësit marrin rolet e personazheve në dialog dhe krijojnë dialogun e tyre.

- a. Mësuesi krijon situatën për lojën me role.
- b. Nxënësve u jepet një rol dhe koha e duhur për të menduar për rolin.
- c. Zhvillohet debat ose diskutim midis nxënësve sipas roleve.
- d. Nxënësit jashtë rolit të tyre diskutojnë për procesin se si u zhvillua debati.

4. Pyetësor ose studim çështjeje

Kjoteknikëndihmon nxënësin të formulojë pyetjet dhe të mbledhë informacionin e duhur, duke nxitur pavarësinë dhe autonominë e tij në procesin e të nxënësit. Gjithashtu, kjo teknikë ndihmon krijimtarinë dhe bashkëveprimin midis nxënësve.

- a. Mësuesi shpjegon informacionin që do të mblidhet.
- b. Nxënësit individualisht, në çift ose në grup, hartojnë pyetjet e pyetësorit për të mbledhur informacionin që u duhet.
- c. Të dhënat e pyetësorit përpunohen në klasë.
- d. Rezultatet diskutohen në klasë.

5. Diskutimi në grupe të vogla

Kjo teknikë përdoret kur mësuesi do të inkurajojë pjesëmarrjen e nxënësve në klasë dhe gjithashtu ndihmon në mbledhjen e opinioneve dhe ideve të nxënësve, si edhe të ulë ankthin e nxënësit për të folur para një publiku të gjerë. Kjo mund të krijojë zhurmë në orën e mësimit e cila është e justifikueshme në klasat e gjuhëve të huaja.

- a. Mësuesi prezanton temën e diskutimit.
- b. Formohen grupet dhe mësuesi jep pyetje për secilin grup.
- c. Grupet marrin kohë mjaftueshëm për të diskutuar dhe debatuar për temën e dhënë.
- d. Nxënësit ndajnë opinionet dhe përgjigjet e pyetjeve me të gjithë klasën.

Mësuesi përdor strategji të ndryshme për ndarjen e klasës në grupe ose çifte.

Shembull

- a. **Grupimi i nxënësve sipas interesave:** Nëse në një temë mësimi nxënësit do të diskutojnë për sportet e ndryshme dhe për avantazhet dhe disavantazhet e secilit prej tyre, mësuesi i ndan nxënësit në grupe sipas pëlqimit të secilit nxënës. (Grupi A: të gjithë ata nxënës që pëlqejnë ose praktikojnë basketbollin; Grupi B: të gjithë ata nxënës që pëlqejnë çiklizmin etj.).
- b. **Grupimi i nxënësve sipas ngjyrës së tyre të preferuar:** Mësuesi përdor letra ose lapsa me ngjyra të ndryshme për secilin grup dhe nxënësi zgjedh të bashkohet me grupin i cili përfaqëson ngjyrën e tij të preferuar.
- c. **Grupimi i nxënësve sipas datëlindjes së tyre:** Mësuesi u kërkon nxënësve të gjejnë shokët ose shoqet të cilët kanë lindur në të njëjtin muaj me të për të krijuar grupin e tyre.

6. Brainstorming

Stuhi mendimesh është një teknikë pune në grup ku secili nxënës përpiqet të gjejë një zgjidhje, të arrijë në një konkluzion për një problem të caktuar ose të gjenerojë ide të reja.


- a. Nxënësit inkurajohen të mendojnë dhe shprehën lirshëm.
- b. Të gjitha idetë listohen në dërrasë ose organizohen në harta semantike dhe nuk kritikohen.
- c. Kur janë shprehur të gjitha idetë, bëhet vlerësimi i secilës prej tyre nga nxënësit duke diskutuar më në detaje.
- d. Mësuesi monitoron dhe ndihmon me fjalor dhe saktësim konceptesh.

7. Harta semantike

Harta semantike është një organizim grafik që i ndihmon nxënësit të organizojnë idetë e tyre, si klasë, në grup ose individualisht. Në lëndën e “Gjuhës së huaj”, harta semantike përdoret për të zgjeruar fjalorin dhe për t’i grupuar fjalët në kategori që lidhen me njëra tjetrën. Një organizues shpesh shoqërohet me ide dhe është i dobishëm për lidhjet midis ideve dhe koncepteve duke u bazuar në njohuritë e marra për të ndërtuar njohuri dhe koncepte të reja, ose për të zgjeruar fjalorin mbi një temë të caktuar. Organizuesit semantikë zakonisht kanë një koncept qendror që rrethohet nga koncepte të tjera kyç që e zbërthejnë atë dhe që mund të bëhen edhe më të hollësishme, sa më shumë që largohen nga koncepti qendror.

Shembull

Në temën mësimore “Ndotja (Pollution)” mësuesi mund të përdorë hartën semantike të mëposhtme për të mbledhur informacion nga nxënësit:



8. *Think-Pair-Share (TPS)*

Këtë teknikë mësuesi e përdor kur nxënësit duhet të zgjidhin një problem së bashku, ose kur nxënësit duhet të dalin me një përgjigje të përbashkët për një pyetje.

- Secili nxënës mendon në mënyrë individuale ose shkruan përgjigjen e pyetjes në fletore (think.).
- Mësuesi i vendos nxënësit në çifte ku ata diskutojnë për përgjigjet e tyre (pair).
- Nxënësit ndajnë mendimet e tyre me të gjithë klasën dhe dalin në konkluzione të përbashkëta (share).

Shembull

Një teknikë shumë e mirë për të ndarë nxënësit në çifte është përdorimi i sinonimeve ose antonimeve të një fjale. Mësuesi përgatit fletë në të cilat është shkruar një fjalë. Nxënësve u jepet kohë të gjejnë shokun/shoqen që ka fletën ku është shkruar sinonimi ose e kundërta e fjalës që ka fleta e tij dhe kështu ai/ajo gjen shokun/shoqen me të cilin do të diskutojë përgjigjet e pyetjes së dhënë.

9. *Know-Want to know-Learned (KWL)*

Di, Dua të di, Mësova është teknikë e cila i ndihmon nxënësit të organizojnë informacionin përpara, gjatë dhe pas një ore mësimi. Mësuesi e përdor këtë teknikë për të inkurajuar nxënësit të jenë sa më aktivë në marrjen e njohurive të reja, në shkëmbimin e rezultateve të të nxënësve si edhe për monitorimin e procesit të të nxënësve.

- Nxënësit krijojnë tabelën K-W-L.

- b. Nxënësit plotësojnë kolonën e parë (What do you know about this topic? - Çfarë dini rreth kësaj teme?). Nxënësit punojnë individualisht ose në çifte. Ndonjëherë mësuesi krijon një listë në dërrasë të të gjitha përgjigjeve të nxënësve. Në këtë fazë mësuesi mund të korrigjojë konceptet e gabuara ose mund ta lërë si detyrë për nxënësit në fund të orës së mësimit.
- c. Nxënësit plotësojnë kolonën e dytë (What do you want to know about this topic? Çfarë dëshironi të mësoni rreth kësaj teme?).
- d. Gjatë orës së mësimit ose në fund të saj nxënësit plotësojnë kolonën e tretë. Gjithashtu nxënësit mund të shtojnë pyetje të tjera tek kolona e dytë të cilat mund të shërbejnë si fillim për orën tjetër të mësimit.

Shembull

Topic: Gravity		
What I know	What I want to know	What I have learned
- it keeps us from floating around - it makes things fall - there is less gravity on the moon - Isaac Newton discovered gravity	- What is gravity? - Why is there less gravity on the moon? - How did Newton discover gravity? - What determines how fast something will fall to the ground. (teacher question)	- Gravity is the force that pulls objects towards the earth. - The amount of gravity there is, depends on the masses of the object involved. The Moon is a lot less massive than the Earth, so there is less gravity on the moon than there is on Earth. - Air resistance determines how fast something will fall to the ground.

Sipas tabelës nxënësit nuk e kanë gjetur në tekst përgjigjen e pyetjes se si Newtoni e zbuloi gravitetin. Për këtë arsye mësuesi inkurajon nxënësit të shohin edhe burime të tjera informacioni për të gjetur përgjigjen e pyetjes.


Gjithashtu, kësaj tabele mund t'i shtohen edhe kolona të tjera, të cilat e ndihmojnë nxënësin drejt të menduarit kritik dhe të pavarur.

- Cilat janë faktet për përgjigjen e dhënë? (What is my evidence?)
- Si unë mund të mësoj më shumë? (How can I learn more?)

10. Diagrami i Venit(Ven Diagram)

Diagrami i Venit ndihmon nxënësit të ilustrojnë lidhjet logjike midis dy fenomeneve, ngjarjeve, personazheve etj., duke nxjerrë në pah ndryshimet dhe ngjashmëritë midis tyre.

Shembull



Në një orë mësimi me temë “Living in a city or in a country”, mësuesi jep si detyrë klase për nxënësit të punojnë në çift plotësimin e diagramës së Ven. Pasi nxënësit plotësojnë diagramën me të veçantat dhe të përbashkëtat e jetës në fshat dhe qytet, ata diskutojnë dhe japin shembuj të ndryshëm për te mbështetur zgjedhjet e tyre.

11. Përdorimi i teknologjisë/internetit¹

Teknologjitë edukative të mësimdhënies kanë evoluar me një shpejtësi marramendëse drejt përfshirjes së mjeteve digjitale në procesin mësimor. Interneti është një burim i dobishëm informacioni për shumë tema dhe një mjet komunikimi me njerëzit. Nxënësi duhet të përdorë aftësi specifike të nevojshme për të kërkuar në informacion në internet dhe më shumë e rëndësishme është vlerësimi në mënyrë kritike e informacionit të grumbulluar. Përdorimi i programeve dhe aplikacioneve të ndryshme në mësimin e gjuhëve të huaja është shumë i rëndësishëm. Përdorimi i teknologjisë mbetet gjithmonë një sfidë për mësuesit dhe nevoja për të zotëruar mësimdhënien online është bërë thelbësore. Është shumë e rëndësishme që mësuesit, të cilët nuk janë ende në gjendje të përdorin teknologjinë, të motivohen në kërkimin dhe përdorimin e burimeve online në celularë (laptop apo tableta) në mënyrë që mësimdhënia e gjuhëve të jetë efektive për nxënësit. Mësuesit duhet të jenë në gjendje të përdorin burime

¹ Për më shumë shembuj referojuni “Mësimi i kombinuar në lëndën e gjuhës së huaj”
<https://www.ascap.edu.al/mesimi-i-kombinuar-ne-lendene-gjuhes-se-huaj/>

si: faqe të internetit, blogje dhe mjete digjitale të cilat i ndihmojnë ata të kalojnë me sukses nga mësimi i drejtpërdrejtë në klasë në mësimin online (ose të kombinuar), si dhe të përshtatin ekspertizën e tyre me situatën aktuale.

Kahoot!

Kahoot!, është një platformë lojërash për mësimnxënien që përdoret nga shumë profesionistë në fushën e arsimit dhe edukimit në botë. Kjo platformë është krijuar për të luajtur, krijuar, zbuluar dhe mësuar. Platforma mund të përdoret në çdo lëndë nga të gjithë mësuesit, për çdo moshë dhe në çdo pajisje duke e bërë procesin e të nxënës me argëtues dhe gjithëpërfshirës. Nxënësit nuk kanë nevojë të regjistrohen në një llogari. Mësuesi mund ta përdorë këtë platformë në klasë, për mësimin në distancë ose të kombinuar, kur është duke përdorur Skype, Zoom ose Google classroom.



Shembull 1

Kahoot! mund të përdoret nga mësuesi për të kontrolluar nëse nxënësit e kanë kuptuar një pjesë leximi. Për këtë arsye, mësuesi harton disa pyetje me alternativa dhe ua dërgon nxënësve. Nxënësit mund t'u përgjigjen individualisht ose në grup.

Shembull 2

Një mënyrë tjetër për të përdorur Kahoot është krijimi i kuizeve të ndryshme për koncepte të caktuara gramatikore, gjuhësore ose fjalorin e ri, ku mësuesi merr informacion se sa materiali i shpjeguar është kuptuar nga nxënësit. Figura tregon sesi mësuesi e ka përdorur Kahoot!, për të testuar njohuritë e nxënësve në përdorimin e fjalëve të reja të mësimin.



Shembull 3

Për të organizuar një orë mësimi interesante, mësuesi mund ta përdorë Kahoot për të hartuar lloje të ndryshme ushtrimesh si: pyetje të vërteta ose të gabuara, pyetje me po ose jo, pyetje të hapura, sondazhe, stuhi mendimesh etj. Gjithashtu mësuesi mund të hartojë ushtrime ku nxënësi:

- gjen cila fjali është gramatikisht korrekte;

- identifikon fjalën që nuk i përket një grupi të caktuar fjalësh;
- gjen sinonimet ose antonimet e fjalëve të dhëna.


Shembull 4

Mësuesi mund të krijojë ushtrime dhe lojërat e veta me Kahoot!, ose mund të marrë modele të gatshme në internet. Një burim shumë i mirë për mësuesit e gjuhës angleze për të përdorur lojëra dhe ushtrime të ndryshme me Kahoot!, të organizuara sipas niveleve gjuhësore është faqja e Cambridge Assessment English <https://www.cambridgeenglish.org/teaching-english/resources-for-teachers/kahoot/>, e cila ofron lojëra Kahoot! pa pagesë.




Mentimeter

Mentimeter është një platformë digjitale e cila përdoret për të krijuar prezantime interaktive, duke rritur përfshirjen e nxënësve në faza të ndryshme të orës së mësimi (hyrjes, prezantimit ose vlerësimit). Mentimeter gjithashtu mund të përdoret për të testuar nxënësit mbi aftësitë e tyre gjuhësore, gramatikore ose fjalorin. Nxënësit marrin rezultatet e testit menjëherë.



Shembull 1


Figura tregon si Mentimeter është përdorur në orën e gramatikës së gjuhës angleze me temën “Prefixes and Suffixes”. Mësuesi, pasi ka shpjeguar përdorimin e parashtesave dhe prapashtesave, poston një pyetje në Mentimeter për të kontrolluar se si nxënësit kanë kuptuar konceptet e reja. Secili nxënës, pasi merr kodin e dhënë nga mësuesi, poston nga një shembull ose më shumë të fjalëve të formuara me to. Pasi të gjithë nxënësit kanë postuar, mësuesi bën një përmbledhje të



shembujve të dhënë.

Shembull 2

Një mënyrë tjetër për ta bërë orën e mësimi interesante dhe tërheqëse për nxënësit, është përdorimi i Mentimeter për vlerësimin e orës së mësimi nga vetë nxënësit. Mësuesi u kërkon nxënësve në Mentimeter: “Shkruaj një gjë që ju pëlqeu nga mësimi i sotëm” dhe nxënësit postojnë mendimin e tyre. Pasi janë marrë të gjitha komentet, mësuesi kërkon nga nxënësit të japin argumente që mbështesin mendimin e tyre duke ndihmuar ata të përmirësojnë aftësitë e tyre folëse dhe argumentuese. Figura tregon se si nxënësit kanë komentuar për orën e mësimi të zhvilluar.




Shembull 3

Mentimeter mund të përdoret me nxënës të niveleve të ndryshme gjuhësore. Në nivelin mesatar ose të avancuar, mësuesi përdor Mentimeter për t'u kërkuar nxënësve të listojnë pyetje ose fjali të dhëna sipas rëndësisë së tyre. Kjo lloj përzgjedhjeje ndihmon nxënësit të zhvillojnë aftësitë e të menduarin kritik dhe të praktikojnë aftësitë e tyre debatuese. Nxënësit reflektojnë rreth temave abstrakte dhe krijojnë argumente për të mbështetur zgjedhjet e tyre. Në një orë mësimi me temën “Protecting our environment” mësuesi u kërkon nxënësve të listojnë problemet (such as greenhouse gas emissions, water pollution, deforestation, etc.) sipas rëndësisë së tyre. Pas votimit, nxënësit diskutojnë dhe japin argumentet e tyre për zgjedhjet që kanë bërë.

Shembull 4

Figura tregon rezultatet e një votimi që një mësues i gjuhës angleze ka zhvilluar në orën e parë të vitit shkollor duke përdorur Mentimeter. Për të vendosur tri rregullat bazë të orës së mësimi nga vetë nxënësit, atyre u kërkohej të votojnë për pesë rregulla, duke i listuar sipas rëndësisë (Be on time; Listen



carefully; Raise your hand; Give your best effort; Respect others). Në klasat e nivelit të lartë, mësuesi u kërkon nxënësve të argumentojnë: “Përse mendoni që këto janë rregullat më të rëndësishme për t’u zbatuar?”

12. Përdorimi i Portofolit Evropian të Gjuhëve (PEGJ)

Nxënësit në lëndën e gjuhës së huaj përdorin Portofolin Evropian të Gjuhëve (PEGJ), i akredituar nga Këshilli i Evropës për t’u përdorur si dokument kurrikular, është hartuar për tre qëllime kryesore:

- a. të mbështesë dhe të zhvillojë autonominë e nxënësit;
- b. të forcojë ndërgjegjësimin ndërkulturor të nxënësit;
- c. të promovojë plurilingualizmin.

Portofoli Evropian i Gjuhëve (PEGJ) përbëhet nga tri pjesë:

1. **Pasaporta Gjuhësore**- siguron një vështrim mbi zotërimin e gjuhëve të ndryshme që nxënësi di, të cilat përcaktohen në bazë të aftësive dhe niveleve sipas Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët. Aftësitë: TË KUPTUARIT (të lexuarit dhe të dëgjuarit); TË FOLURIT (ndërveprues dhe produkti i të folurit); dhe TË SHKRUARIT. Ndërsa nivelet janë: Niveli bazë (Para A1; A1-zbulimi i gjuhës, A2-mbijetesa gjuhësore); Përdoruesi i pavarur (B1- Pragu i njohjes gjuhësore, B2- Zotërimi i gjuhës) dhe Zotëruesi i gjuhës (C1- Zotërimi shumë i mirë; C2- Zotërimi i plotë). Përfshirja e vetëvlerësimit në pasaportë thekson që PEGJ i përket nxënësit dhe jo institucionit.
2. **Biografia Gjuhësore**- ndihmon nxënësin të reflektojë mbi progresin e tij, të marrë pjesë në planifikim, e inkurajon të theksojë se çfarë mund të bëjë në secilën gjuhë që po mëson si edhe të informojë për përvojat gjuhësore të fituara gjatë dhe jashtë procesit të të nxënës. Nga pikëpamja pedagogjike biografia gjuhësore luan një rol thelbësor duke përqendruar vëmendjen në procesin reflektiv që ndërmjetëson pasaportën gjuhësore me dosjen.
3. **Dosja**- i ofron nxënësit mundësinë për të përzgjedhur materiale që dokumentojnë e ilustronë arritjet dhe përvojat e regjistruara në Biografinë Gjuhësore ose në Pasaportë. Nxënësi mund ta plotësojë dosjen me rezultatet e punës së tij, të tregojë aftësitë në të shkruar e në të folur dhe mund ta realizojë edhe me anë të përfshirjes së CD në dosjen e tyre.

Detyrat e portofolit mund të jenë punime të kryera në klasë dhe/ose jashtë saj, dëshmi e kontributeve dhe talentit të nxënësit të cilat nxënësi i përzgjedh bazuar në përshkruesit e Biografisë Gjuhësore tek PEGJ për një aftësi të caktuar (të lexuarit, të dëgjuarit, të folurit, të shkruarit) dhe nivelit përkatës (B1-B2). Detyrat duhet të përfshijnë të gjitha aftësitë e gjuhës (të folurit, të dëgjuarit, të shkruarit dhe të lexuarit).

PEGJ ka dy funksione:

- a. **Raportues**- tregon aftësitë e nxënësit në lidhje me gjuhët e huaja që ai di ose po mëson, duke dhënë informacion rreth përvojave dhe shembuj konkretë mbi arritjet e tij në këto gjuhë. Rëndësia e funksionit raportues të PEGJ-it ndryshon sipas moshës së nxënësit.
- b. **Pedagogjik**- PEGJ është hartuar me synimin e bërjes transparent të procesit të të nxënës të gjuhëve, duke ndihmuar nxënësin të zhvillojë kapacitetin për reflektim dhe vetëvlerësim. Ky funksion përkon me synimet e Këshillit të Evropës për forcimin dhe zhvillimin e autonomisë të nxënësit.

Përdorimi i PEGJ në klasë

Duke qenë një dokument kurrikular mësuesi duhet të planifikojë veprimtari të larmishme që nxënësi të punojë me këtë dokument si p.sh: punë në grup, punë në çift, ushtrime të krijuara nga nxënësit, diskutime etj. (orët e PEGJ planifikohen brenda orëve të projektit).

Në fillim të vitit shkollor, mësuesi prezanton PEGJ dhe shpjegon nivelin gjuhësor që nxënësi duhet të arrijë në fund të vitit duke organizuar ushtrime që ju referohen përshkruesve të atij niveli për secilën nga aftësitë gjuhësore.

Më poshtë po prezantojmë disa shembuj praktikë se si mund të punohet në klasë me PEGJ. Këta shembuj nuk janë shterues dhe mësuesi duke diskutuar me nxënësit mund të zhvillojnë veprimtari të shumta krijuese dhe të larmishme.

Shembull 1

Puna me Portofolin Evropian të Gjuhëve fillon në fillim të vitit shkollor, datë 26 Shtator (Dita Evropiane e Gjuhëve), ku nxënësve ju jepet mundësi të shprehin nëpërmjet veprimtarive ose punimeve të ndryshme njohuritë që ata kanë në gjuhë të huaj duke promovuar shumëgjuhësinë dhe diversitetin gjuhësor dhe kulturor.



Nxënësit marrin pjesë me punimet e tyre në konkursin që shpallet çdo vit nga Qendra Evropiane e Gjuhëve Moderne, ose bashkëpunojnë edhe me nxënës të shkollave të ndryshme në Shqipëri, rajon dhe më tej. <https://edl.ecml.at/>

Shembull 2

Mësuesi shpjegon funksionin raportues të PEGJ, thekson vlerën e shkallës së përbashkët Evropiane të zotërimit të gjuhës, inkurajon diskutim mes nxënësve rreth përvojave të mësimi të gjuhëve, tregon modelin e një portofoli të hartuar nga nxënësit e viteve të mëparshme. Gjithashtu mësuesi nxjerr në pah idetë e nxënësve se si ta përdorim PEGJ në klasë.



Shembull 3

Nxënësit diskutojnë në grupe se çfarë ata mund të bëjnë në gjuhën e huaj që po mësojnë. Ata gjithashtu vendosin se çfarë ata duan të mësojnë gjatë vitit të ri shkollor. Kjo veprimtari mund të realizohet në fillim të vitit kur mësuesi prezanton PEGJ dhe përshkruesit për nivelin e caktuar. Nxënësit përgatisin postera duke u bazuar tek përshkruesit e aftësive gjuhësore të nivelit gjuhësor që ata janë dhe posterat vendosen në klasë për të shërbyer si pikë referuese në fund të çdo periudhe.

Shembull 4

Mësuesi ndan klasën në grupe dhe u kërkon atyre të shikojnë me vëmendje përshkruesit për një aftësi të caktuar për secilin grup në nivelin ku janë duke punuar (p.sh: B1 Klasa X; B1+ klasa XI; B2 klasa XII) dhe t'u përgjigjen pyetjeve: (a)- Ku jam unë në lidhje me këtë përshkrues? (b)- Çfarë më mbetet për të bërë? Etj. Mësuesi më pas u kërkon nxënësve të vendosin një objektiv që do të dëshironin të arrinin në muajt e ardhshëm, ta diskutojnë me shokun përkatës dhe ta shënojnë në biografinë gjuhësore të tyre. Pas një ose dy muajsh, mësuesi ndan përsëri klasën në grupe në orën e punës me PEGJ dhe u kërkon nxënësve të vlerësojnë veten dhe njëri-tjetrin nëse e kanë arritur objektivin e vënë ose jo. Ndërgjegjësimi i nxënësve për vendimmarrje, vlerësimi dhe vetëvlerësimi në këtë nivel shkollimi është shumë i rëndësishëm, pasi ata përgatiten për të qenë përdorues të pavarur të gjuhës së huaj që po mësojnë.

Shembull 5

Gjatë orëve të projektit kurrikular mësuesi ju jep nxënësve një ushtrim me kombinime duke përdorur përshkrues të katër aftësive për nivelet B1-B2.

Niveli B2- Anglisht- Reading

1	I can rapidly get	A	articles and reports on nowadays problems in which the writer express specific attitudes and points of view.
2	I can read and understand	B	Articles outside my own academic field or professional one by consulting the disctionary if necessary.
3	I can understand in details	C	the content and the importqnce of news, articles within my interest and decide if a closer reading is necessary
4	I can understand specialized	D	texts within my field of interest or the areas of my academic or professional speciality.
			

(1-C; 2-A; 3-D; 4-B)

Pas këtij ushtrimi nxënësit zgjedhin përshkruesin me të cilin duan të realizojnë projektin e tyre.

Shembull 6

Mësuesi u kërkon nxënësve të shkruajnë një tekst në gjuhën e huaj që po mësojnë duke iu përgjigjur pyetjes “Çfarë nxënësi jam unë?”, duke u sugjeruar që të mendojnë për tre mbiemra të cilët reflektojnë karakteristikat pozitive të të nxënësve të gjuhës së huaj dhe tri mbiemra për tri veçori negative të të nxënësve të gjuhës. Gjithashtu mësuesi u sugjeron nxënësve të listojnë tri teknika dhe veprimtari që ata i shohin të dobishme. Së fundi, mësuesi u kërkon nxënësve të shkruajnë një përvojë të suksesshme të të nxënësve të gjuhës.

Shembull 7

Mësuesi u jep nxënësve si detyrë shtëpie ose klase të lexojnë një tregim, artikull gazete ose një artikull në internet dhe u kërkon të hartojnë ushtrime për të. Nxënësit janë të lirë të zgjedhin llojin e ushtrimit duke u mbështetur në dy fusha: (a) përmbajtjen “content based” – pyetje rreth tekstit, e vërtetë e gabuar, dialogje, quize (kuize) etj; (b) forma si për shembull: plotëso vendin bosh, ushtrime transformuese, ushtrime me kombinime etj. Përpara se ushtrimi të zhvillohet me të gjithë klasën, nxënësi duhet t`u shpjegojë shokëve zgjedhjen që ka bërë, pse dhe se si e ka krijuar ushtrimin. Kjo veprimtari synon përmirësimin e kuptimit të

të lexuarit, mbështet metoda aktive të të nxënit si edhe kalon përgjegjësinë nga mësuesi tek nxënësi.

VII. PLANIFIKIMI I LËNDËS DHE MODELE TË PLANIFIKIMIT LËNDOR

Planifikimi është një proces i rëndësishëm i zbatimit të kurrikulës, i cili i krijon mundësinë mësuesit të jetë krijues, i lirë dhe sa më efektiv në procesin e mësimdhënies. Për një planifikim të mirë, mësuesi duhet të njohë dokumentet e mëposhtme:

- kornizën kurrikulare;
- kurrikulën bërthamë;
- programin mësimor.

Baza e një planifikimi të suksesshëm është njohja e mirë e programit mësimor. Mësuesi duhet të zbatojë me përpikmëri të gjitha kërkesat e këtij programi. Rezultatet e të nxënit janë një themel i përbashkët për të gjithë mësuesit. Ata përzgjedhin vetë metodat dhe strategjitë më të përshtatshme, burimet e mundshme për t'u shfrytëzuar, llojet dhe mjetet e vlerësimit.

7.1 Llojet e planifikimeve

Planifikimi i mësimdhënies për lëndën ose modulin përfshin:

- planifikimin vjetor;
- planifikimin për secilën periudhë;
- planifikimin ditor.

Në fillim të vitit shkollor mësuesi duhet të dorëzojë pranë drejtorisë së shkollës *planin vjetor* të lëndës ose të modulit, i cili shërben si një kornizë e ndarjes së përgjithshme të përmbajtjes lëndore dhe të orëve mësimore, si edhe *planin e periudhës së parë* (shtator-dhjetor). Planet e periudhës së dytë dhe të tretë dorëzohen para fillimit të secilës periudhë.

Gjatë vitit, sipas rrethanave që i krijohen, mësuesi mund të bëjë ndryshime në planin fillestar mësimor. Mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë nga sa e ka parashikuar, kur vë re se nxënësit e tij hasin vështirësi. Në këtë mënyrë mësuesi planifikon duke u bazuar në përparimin e nxënësve dhe në vështirësitë e hasura në periudhat paraardhëse, duke u përqendruar tek arritjet e kompetencave kyç dhe të lëndës.

7.2 Planifikimi vjetor i lëndës

Për planifikimin vjetor të lëndës, mësuesi, përveç programit mësimor duhet të njohë edhe tekstin që ka përzgjedhur për atë vit shkollor. Natyrisht, realizimi i programit është qëllimi i vërtetë i mësuesit, kurse teksti mësimor i përzgjedhur është një mjet për ta përmbushur këtë qëllim. Kur mësuesi sheh se teksti nuk i ka dhënë vendin e mjaftueshëm përvetësimit të një rezultati të nxëni të programit, ai e plotëson vetë këtë mungesë të tekstit, duke përdorur burime të tjera të nxëni.

Plani vjetor është një plan sintetik. Mësuesi planifikon orët dhe përmbajtjen kryesore lëndore për tre periudha. Periudhat janë:

- periudha e parë: shtator-dhjetor;
- periudha e dytë: janar-mars;
- periudha e tretë: prill-qershor.

Periudhat nuk janë semestra, por janë periudha reflektimi për mësuesit dhe nxënësit, duke reflektuar mbi punën dhe rezultatet e tyre dhe si mund të përmirësohet në vazhdim.

Më poshtë jepet tabela e planifikimit të orëve mësimore në AML për gjuhën e huaj të parë dhe të dytë. (Klasa X-XI - 36 javë mësimore; Klasa XII - 34 javë mësimore)

Gjuha e huaj e parë	Formimi kulturor	Formimi gjuhësor		Projekti dhe Portofoli Evropian i Gjuhëve (PEGJ)	Totali i orëve
		Gramatika	Funksionet gjuhësore		
Klasa e X; XI (36 x 3 = 108)					108 orë
	40%	30%	20%	10%	
	44 orë	32 orë	21 orë	11 orë	

Gjuha e huaj e parë	Formimi kulturor	Formimi gjuhësor		Projekti dhe Portofoli Evropian i Gjuhëve (PEGJ)	Totali i orëve
		Gramatika	Funksionet gjuhësore		
Klasa XII (34 x 3 = 102)					102 orë
	40%	30%	20%	10%	
	41 orë	31 orë	20 orë	10 orë	

Gjuha e huaj e dytë Klasa X, XI (36 x 2 = 72)	Formimi kulturor	Formimi gjuhësor		Projekti dhe Portofoli Evropian i Gjuhëve (PEGJ)	Totali i orëve
		Gramatika	Funksionet gjuhësore		72 orë
	40%	30%	20%	10%	
	29 orë	22 orë	14 orë	7 orë	

Gjuha e huaj e dytë Klasa XII (34 x 2 = 68)	Formimi kulturor	Formimi gjuhësor		Projekti dhe Portofoli Evropian i Gjuhëve (PEGJ)	Totali i orëve
		Gramatika	Funksionet gjuhësore		68 orë
	40%	30%	20%	10%	
	27 orë	20 orë	14 orë	7 orë	

Mësuesi ka të drejtë të ndryshojë deri në masën 10% të orëve të përcaktuara në tabelë duke pasur parasysh karakteristikat e çdo klase si edhe përparimin e nxënësve.

Në orët e formimit kulturor trajtohen pjesët e reja të leximit dhe të dëgjimit, të cilat përfshijnë njohuritë që merr nxënësi mbi botën e punës, shkollës, jetës personale, natyrës, udhëtimet, kulturat dhe traditat e vendeve të ndryshme etj., duke ndihmuar në krijimin dhe forcimin e kompetencave kyç. Nëse mësuesi vë re se disa njohuri nuk mund të përvetësohen nga nxënësi brenda një ore mësimore, ai planifikon orë rimarrje për ato njohuri.

Orët e formimit gjuhësor mbi gramatikën përfshijnë njohuritë gramatikore dhe punën me fjalorin që realizohet gjatë vitit. Këtu mund të përfshihen edhe orët e përforsimit të njohurive nëse mësuesi e shikon të nevojshme. Gjithashtu njohuritë gramatikore nuk mund të merren jashtë kontekstit dhe duke pasur parasysh që përqasja në kurrikulën bërthamë është të mësuarit nëpërmjet situatave të të nxënësve, këto njohuri mund të ndërthuren edhe gjatë orëve kur fokusi është të folurit ose të shkruarit.

Funksionet gjuhësore u referohen akteve të komunikimit, që nxënësi realizon gjatë procesit të marrjes së gjuhës së huaj dhe mund të realizohen në përputhje me njohuritë dhe shkathhtësitë e tjera.

Duke pasur parasysh se vlerësimi i nxënësit bëhet edhe nëpërmjet projektit lëndor, mësuesit duhet të planifikojnë orë për realizimin e tij. Gjatë orëve të projektit, mësuesi krijon hapësirë dhe cakton orë që nxënësit të punojnë edhe me Portofolin Evropian të Gjuhëve si një instrument që e ndihmon nxënësin për të vendosur rezultatet e të nxënit për realizimin e projektit dhe për të bërë vetëvlerësimin e punës së tij.

Teste të detyruara gjatë një viti shkollor janë 3, të cilat kryen rreth përfundimit të çdo periudhe por JO detyrimisht orën e fundit të periudhës.

Model planifikimi vjetor

Lënda: Gjuhë e huaj Anglisht

Klasa: X/XI

TOPICS	Subject content distribution		
	September -December (39 hours)	January – March (36 hours)	April - June (33 hours)
1 Let's Start 9 hours	A- Home Sweet Home B- At the Movies C- D- Self assessment (ELP- European Language Portfolio) E- Project F- Workbook exercises		
4..... Appearances 10 hours			
5..... 10 hours		A- Personality B- Vocabulary C- D- Culture Corner E- Project and ELP F- Workbook	

		exercises	
8 Going Places 16 hours			A- Travelling B- C- D- Project and ELP Workbook exercises
9..... 17 hours			

**Shënim: Në klasën XII, mësuesit planifikojnë në fund të vitit shkollor orë për përgatitjen e nxënësve për provimin e detyruar të gjuhës së huaj. Këto orë mund të merren si nga orët e formimit kulturor ashtu edhe nga orët e formimit gjuhësor.*

7.3 Planifikimi sipas periudhave

Planifikimi i periudhës është një planifikim më afatshkurtër dhe më i detajuar i mësimdhënies. Ai është analitik dhe në të detajohen temat mësimore që do të zhvillohen përgjatë saj. Mësuesi harton planifikimin e periudhës përkatëse në fillim të saj dhe e dorëzon në drejtorinë e shkollës para fillimit të periudhës. Ky plan hartohet duke iu përmbajtur programit dhe tekstit mësimor përkatës. Në planet sipas periudhave planifikohen të gjitha orët. Mësuesit janë të lirë të bëjnë ndryshimet e tyre hap pas hapi, në varësi të specifikave të lëndës së tyre.

Ky lloj planifikimi kërkon që mësuesi të përcaktojë me kujdes:

a. Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave kyç

Në këtë rubrikë mësuesi do të vendosë rezultatet e të nxënësve të kompetencave kyç, të cilat do të zhvillohen nga nxënësit përgjatë temave mësimore, të zhvilluara gjatë kësaj periudhe. Mësuesi i përzgjedh këto rezultate në programin mësimor, të rubrika “Rezultatet kryesore të të nxënësve, sipas kompetencave kyç që realizohen nëpërmjet lëndës së ...”.

b. Rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të lëndës

Në këtë rubrikë vendosen rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të lëndës, të cilat do të arrihen nga nxënësi nëpërmjet zhvillimit të këtyre temave mësimore. Mësuesi i përzgjedh këto rezultate të nxënësve nga programi mësimor sipas tematikave të përmbajtjes së lëndës.

c. Numrin rendor

Këtu vendosen numrat për temat mësimore. Totali i numrave në planin e periudhës përkon me numrin e orëve që janë përcaktuar në planin vjetor të lëndës ose të modulit.

d. Kapitullin

Në këtë rubrikë shënohen kapitujt mbi të cilat është ndërtuar teksti i lëndës.

e. Temat mësimore

Në këtë rubrikë shënohen të gjitha temat mësimore që do të zhvillohen gjatë periudhës. Kjo rubrikë përmban *orë të detyruara për t'u planifikuar*:

- temat mësimore brenda të cilave do të realizohen rezultatet e të nxënit. mësuesi orientohet sipas tekstit mësimor;
- orët e projektit/eve kurrikulare që do të zhvillojë mësuesi për zbatimin dhe demonstrimin e aftësive të fituara në lëndën e gjuhës së huaj si dhe për zhvillimin e kompetencave të lëndës e kompetencave kyç. mësuesi, në varësi të kushteve specifike planifikon në lëndën e gjuhës së huaj 10 -11 (gjuha e huaj e parë) dhe 7 orë (gjuha e huaj e dytë) projekte kurrikulare. në këto orë do të përfshihen edhe orët që do punohet me Portofolin Evropian të Gjuhëve (PEGJ);
- orë ushtrimesh, përpunim njohurish, përsëritje për testin përmbledhës, etj. për të konsoliduar dhe zbatuar konceptet e fituara në lëndën e gjuhës së huaj;
- orët e testeve përmbledhëse për të matur njohuritë e fituara nga nxënësit në periudhën përkatëse. mësuesi planifikon 3 teste përmbledhëse, nga një për çdo periudhë. testet përmbledhëse planifikohen kur mësuesi e shikon të arsyeshme kohën e zhvillimit të tij, d.m.th jo detyrimisht në fund të periudhës, por edhe disa javë përpara se të mbarojë periudha;
- orë sipas specifikave të lëndës p.sh: vizita në muze, ekskursionet, konkurse, debate etj.

f. Situata e të nxënit

Në këtë rubrikë vendosen situatat e të nxënit që mësuesi parashikon të realizojë gjatë periudhës, të cilat mund të ndryshohen dhe plotësohen përgjatë zhvillimit të lëndës. Situatat e të nxënit mund t'i përkasin një teme mësimore, disa temave mësimore, ashtu sikurse mund të ketë tema mësimore për të cilat mësuesi nuk zhvillon situata të nxëni. Me situatë të nxëni kuptohet ndërtimi i njohurive nëpërmjet një situatë praktike ose reale si pjesë e metodologjisë dhe organizimit të klasës.

g. Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve

Në këtë rubrikë mësuesi vendos teknikat dhe metodat e mësimdhënies (p.sh, harta e konceptit, parashikimi me terma paraprakë, debat, dialog, punë në grup etj.) që do të përdoren gjatë zhvillimit të këtyre temave në një periudhë të caktuar (jo shumë e detajuar, sepse e tillë kjo rubrikë detajohet në planifikimin ditor).

h. Vlerësimi

Këtu vendosen teknikat e vlerësimit që do të përdoren gjatë zhvillimit të këtyre temave në një periudhë të caktuar si p.sh., vlerësimi i përgjigjeve me gojë; vlerësimi i punës në grup; vlerësim mes nxënësish; vlerësim i aktivitetit gjatë debateve në klasë; vlerësim i detyrave të shtëpisë; vetëvlerësim; intervistë me një listë treguesish; vëzhgim me një listë të plotë treguesish; prezantim ose punë me gojë ose me shkrim, projekt kurrikular etj. Kjo rubrikë nuk detajohet shumë, sepse është e detajuar në planifikimin ditor.

i. Burimet

Në këtë rubrikë mësuesi vendos burimet që do të përdoren për arritjen e rezultateve të të nxënës si p.sh. teksti i nxënësit, teksti i ushtrimeve (nëse ka të tillë), materiale të përgatitura nga mësuesi ose nxënësi etj. Kjo rubrikë nuk plotësohet në mënyrë shumë të detajuar, pasi e tillë do të plotësohet në planifikimin ditor.

Model planifikimi i orëve mësimore për një periudhë

Në modelin e mëposhtëm paraqitet një model sugjerues se si mund të planifikohet pjesa e fundit e një periudhe në gjuhën angleze.

SECOND PERIOD PLANNING

FIELD: Languages and Communication

Subject: English XI

Key Competences Learning Outcomes
The student:
- discusses and shares his/her experiences with others in doing research and using the proper strategies for effective learning;
- utilizes various techniques and strategies to solve different assignments or tasks;
- designs a project by setting the goals, dates, activities, materials and resources needed and presents it fluently;
- uses ELP (European Language Portfolio) as a tool to identify his/her strengths and weaknesses and also to

set goals for the future learning and career development; -						
Subject Competences Learning Outcomes The student: - has sufficient range of language to talk about travelling experiences, different means of transport, geography and natural disasters; - understands the main points of a conversation or a monologue; - finds specific details in short texts or interviews; - communicates with reasonable accuracy when talking about past states and repeated actions; - expresses and justifies his/her opinion in discussing topic of interest; - presents and supports arguments in a “for and against” essay. -						
No	Topics	Topics per hour	Learning situations	Methodologies and students activities	Assessment	Resources
5	10 hours					
7	Our World 14 hours	1. Natural disasters-reading and vocabulary 2. Grammar-articles 3. Listening and exercise 4. Speaking 5. Google Earth-Reading 6. Grammar-Non-defining relative clauses	Google Earth Students divided into groups are asked to use google earth and to find a place they want to describe and use the information based on google earth as well as by doing research. They may also	- group work - pair work - brainstorming - questions and answers - gap filling - matching exercises - games - test	- observation - assessing answers - assessing group work - assessing home work - using checklists - self-assessment	- student book - work book - picture dictionary - CD - Internet - Digital platform - Posters, photos - ELP

		7. Speaking	brainstorm on the ways that people can use Google Earth.			
		8. Writing a ‘for and against’ essay.				
		9. Reinforcement				
		10. Test				
		11. Project ²				
		12. Project				
		13. Project and ELP				
		14. Debate				

7.4 Planifikimi ditor

Mësuesi planifikon çdo orë mësimore duke pasur parasysh specifikat e çdo ore mësimore dhe klase. Në ndryshim nga planifikimi tradicional, në planifikimin e kurrikulës me kompetenca kemi këto ndryshime:

Planifikimi (tradicional) i orës së mësimit	Planifikimi bazuar në kompetenca i orës së mësimit
Në planifikim përcaktohet çfarë bën mësuesi për të realizuar mësimin.	Në planifikim përcaktohet çfarë bëjnë nxënësit ndërsa realizohet mësimi (situatat, veprimtaritë, detyrat).
Mësimi përqendrohet pothuajse te përmbajtja.	Mësimi përqendrohet mbi proceset dhe mbi veprimtaritë.
Mësimi pritet të ketë të njëjtin organizim të orës së mësimit gjithmonë.	Mësimi nuk ka të njëjtën metodologji gjithmonë. Organizimi varet nga rezultatet që duam të arrijmë.
Roli i mësuesit është kryesisht ligjërues (shpjegon).	Roli i mësuesit është organizator duke mbizotëruar dhe duke e vënë theksin te bashkëveprimi i nxënësve.

Shembuj të foljeve për rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave të lëndës së gjuhës së huaj Gjuhë angleze

²Orët e projektit mund të zhvillohen edhe të shpërndara. Në varësi të mundësive dhe fleksibilitetit që ka, mësuesi mund të planifikojë 2-3 orë orë projekti kurrikula, për një periudhë.

Bloom's Taxonomy	Measurable Verbs
Remember	arrange, choose, cite, copy, define, describe, draw, duplicate, identify, label, list, locate, match, memorize, name, order, outline, quote, read, recall, recite, repeat, reproduce, select, state, underline, etc.
Understand	articulate, associate, characterize, cite, clarify, classify, compare, contrast, convert, defend, demonstrate, describe, differentiate, discuss, distinguish, estimate, explain, express, identify, illustrate, indicate, interpret, locate, match, observe, organize, etc.
Apply	act, adapt, apply, calculate, change, choose, classify, complete, construct, demonstrate, develop, discover, dramatize, employ, explain, generalize, identify, illustrate, implement, interpret, interview, manipulate, modify, operate, predict, prepare, etc.
Analyze	analyze, appraise, break down, categorize, classify, compare, conclude, contrast, correlate, criticize, debate, deduce, detect, diagnose, diagram, differentiate, discriminate, dissect, distinguish, evaluate, examine, experiment, group, identify, infer, inspect, etc.
Evaluate	appraise, argue, assess, attach, choose, compare, conclude, contrast, create, criticize, critique, decide, defend, describe, design, determine, discriminate, estimate, evaluate, grade, invent, judge, manage, mediate, rate, reconcile, etc.
Create	arrange, assemble, choose, collect, combine, compile, compose, construct, create, design, develop, devise, evaluate, facilitate, formulate, generalize, generate, hypothesize, improve, integrate, invent, make, manage, modify, originate, plan, etc.

Gjuhë frënge

la taxonomie de Bloom	verbes mesurables
Souvenir	lister, nommer, mémoriser, répéter, entourer, distinguer, identifier, définir, réciter, citer, faire correspondre, décrire, formuler, étiqueter, écrire, énumérer, souligner, reproduire, organiser, choisir, copier, dessiner, ordonner, classer.

